

Jeta



nr. 57, viti VII
janar - mars 2008

Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga tre muaj - Trimestrale della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs)

Spedizione in A.P. - TAXE PERÇUE - art. 2 comma 20/c - L.662/96, Aut. n. DCO/DC/CS/101/2003, valida dal 06/03/03

Republika e Kosovës

Bardh Rugova

Universitet i Prishtinës, Kosovë

Më se njëzet shtete, në mesin e të cilave shtetet më të rëndësishme të Perëndimit, e kanë njohur tashmë Kosovën si shtet të pavarur. Një rrugë e nisur moti, është kurorëzuar më 17 shkurt, kur Kuvendi i Kosovës ka miratuar deklaratën e pavarësisë, të shpalljes së shtetit të ri, Republikës së Kosovës. Qindra mijë kosovarë kanë kremtuar deri në mëngjes, nën ndriçimin e fishekzjarrëve. “Independence is better than sex”, (Pavarësia është më e mirë se seksi) ka qenë mbishkrimi në fanellat e disa të rinjve kosovarë në ditën e kremtes. Një obelisk gjigant është ngritur enkas për këtë ditë në qendër të kryeqytetit, Prishtinës. Shkronja të mëdha, të verdha japin mesazhin “New born” (I porsalindur) dhe mbi ato shkronja qytetarë të Prishtinës kanë pasur mundësi të shënonin emrat e tyre gjatë mbrëmjes festive. Gjatë dy javëve të para si shtet, Kosova ka kaluar me sukses edhe testin e parë. Institucionet e shtetit të ri dhe qytetarët kanë arritur që të ruajnë gjakftohtësinë dhe të mos bien pre e provokimeve që bëheshin nga ana e Serbisë, e cila është kundërshtuesja më e madhe e pavarësisë së Kosovës.

Prej vitit 1999, kur NATO-ja ka përzënë forcat serbe nga Kosova, vendi është administruar nga një mision i OKB-së, i quajtur UNMIK. Tani, pritet që UNMIK-u t'i lëshojë vend një misioni të ri, evropian. Mirëpo, misioni i BE-së nuk do ta zëvendësojë UNMIK-un. Kosova është shtet i pavarur dhe ka organet e saj. Së shpejti NATO-ja do të fillojë edhe me përgatitjet për ndërtimin e Ministrisë së mbrojtjes dhe të forcave të armatosura të Kosovës. UNMIK-un do ta zëvendësojnë autoritetet shtetërore të Kosovës, ndërsa BE-ja, me dy misionet e saj, do të ketë detyra të ndryshme nga ato të UNMIK-ut. Këto

detyra janë në pajtim me Prishtinën e jo të imponuara nga New Yorku, siç ka qenë autoriteti i UNMIK-ut. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë kanë reaguuar shtetet perëndimore. SHBA-ja, Britania e Madhe, Italia, Franca, Gjermania janë në mesin e shteteve të para që e kanë njohur shtetin e ri. Kosovarët konsiderojnë se shpallja e pavarësisë njëherësh shënon edhe një

larje të vogël të padrejtësisë historike.

Në fund të shekullit XIX, patriotët shqiptarë në Vilajetin e Kosovës, një cep i largët i Perandorisë Osmane, organizonin kryengritje në kërkim të autonomisë. Pikërisht, një kryengritje e tillë, më vite më vonë, 1912, do t'i përzinte otomanët nga Kosova. Mirëpo, derisa kryengritësit shqiptarë po i ndiqnin turqit nga trojet e veta, ushtritë serbe dhe bullgare do të marshonin në Kosovë. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, do ta miratonte atë pushtim dhe Kosova do të lihej jashtë territorit të Shqipërisë, pjesë e Mbretërisë Serbe-Kroato-Slllovene. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, ajo do të lihej pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, si krahinë e Serbisë, por më 1974, me ndryshimet kushtetuese të këtij shteti, do të shndërrohej në njësi kushtetuese, njësoj si republikat e tjera: Sllovenia, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Serbia. Dezintegrimi i Jugosllavisë ka nisur në

fillim të viteve nëntëdhjetë me shkëputjen e Sllovenisë. Bosnja dhe Kroacia janë shkëputur pas luftërash të përgjakshme, ndërsa pa luftë janë shkëputur edhe Maqedonia e Mali i Zi. Analistë ndërkombëtarë pohojnë se pavarësia e Kosovës e përmbyll procesin e dezintegrimit të Jugosllavisë.



Più di venti nazioni, tra cui le più importanti d'Europa, hanno già riconosciuto la Kosova quale stato indipendente. Una lunga strada, coronata il 17 febbraio, quando il Parlamento di Prishtina ha approvato la dichiarazione di Indipendenza e la proclamazione del nuovo Stato, la Repubblica della Kosova. Centinaia di migliaia di persone hanno festeggiato fino all'alba sotto l'illuminazione dei fuochi d'artificio. E sulle magliette di alcuni giovani kosovari c'era scritto: "L'Indipendenza è meglio del sesso". Nelle prime due settimane come Stato indipendente, la Kosova ha superato il test: istituzioni e cittadini hanno mantenuto il sangue freddo e non hanno risposto alle provocazioni serbe. Dal 1999, quando la Nato ha scacciato le forze serbe dalla Kosova, il territorio è amministrato dall'Unmik. Ora si aspetta che una nuova missione civile europea aiuti il nuovo stato indipendente a organizzarsi e che la Nato inizi a formare le forze armate della Kosova. Il riconoscimento dell'Indipendenza della Kosova da parte delle maggiori nazioni europee rappresenta una piccola soddisfazione per le tante ingiustizie storiche subite dalla Kosova in passato.

Dielli shkëlqen, dheun mbjon pjot të mira

Lexha 482/99 e Skolla

Lucia Cardamone

ka Shën Sofia (Cs)

Mario Giuseppe Miracco / Moti Madh

ka Shën Sofia (Cs)



Gjithë katundet Arbëreshë kanë një monumend, që mban mend e jep domethënë se janë Arbëreshë.

Katundi im, njera dje, ish pa fare, ndomos se monumende kemi di o tre. Te ajri rrij e vinij era e një monumendi që kish lehej sot menat ndi katund.

Te bashkia hapet një gar, ku marren pjes mjeshttra arbëreshë e lëti, sa t' bëhej kët shëng që kish jip domethënë "Arbëreshëve d'Italia".

Shkon pak mot, arrëvönjen shënge që burtonjen mbalë kartës monumentin

që ka të përfaqësonj "Arbëreshët d'Italia."

Nikoqiri mbitar një komisjon e mbësuar, sa t' zgjethë shëngun më të bukur, hapet një të folë e dhezur, pra ndë fund e zgjedhen: "E Bukura More".

Një shëngë i tharet me shumë faqe, është tundulluar, është një palë, mund e rucë ka gjithë anet, mënd t'i jaç ëmrin që të parir, mënd llavçë trut t'i jaç që domethënë.

Arrëvön dita, arrëvön edhe mjeshtri që ka t' stisinj monumendin, sheshi Trapëzes vjen i masur sa t' zgjidhej lloku.

Arrëvön një i vendit e pien një mjeshter që bëhej.

Mieshtri rispëdoj: "Zgjedhmi llokun monumendit, që ka të përfaqësonjë "Arbëreshët d'Italia", ju që jini i vendit që thoni, vete mir këtu ndë mes t' sheshit?>

Mjeshtri i burton shëngun, e pien nd'i parir; tue folë, qasen afer rangieres, arbreshi i thot mjeshtrit: <<"Trapëza është zëmra katundit, ndë ish për mua e vëja ka ana kruxhuvisë, atej sheshit, këtjë nëng vjeth llok. Sheshi ka t' rrij vakand per gjindjen; nëng shini si ven e vinjen gjindja? Këtu është Bashkia, shpia Zotit, Skolla Fëmijëve, Jatroj për bëzonjet naten, Ambullatori Sanitar, kan hapnjen Muzeun. Shëngu vjedh lok burrit, pra ndomos të jet i bukur, njeri ka mose që thot, ndë vjedhë sheshin e shanjen më shumë >> . Mjeshtri mbjedh rrot gjithë shoktë, i thot mendimin që gjegji, bi t' hapet një t' folur i ri, daledal mendimi i parir.

Mjeshtri zu e stisi ndomos njeri shkonij e tundnij kriet: pala u rrit, rrëvoi ndë mest.

Një menat u gjënd e fërnuar e mbushtruar ka një kurtin.

Shumë doj kalljin hundën të shighjin, mosnjeri e zbuloi.

Naten penxoi moti i ligë, ajri e shiu, të vullarnij kurtinen.

Menatet, monumendi shëlqenij, bashkë me një e bukur ditë, e kuetem prapa një trupit.

At menatë nganjë që shkonij, i perqasnej një fandonje që i shkonij për krie: I gjet njëj furri! I gjet një ve e zier! I gjet një naranaxat! I gjet njëj dialli mbë gjisem! I gjet një folë! Ç'ë kjo palë?

Qe një mbëkat se mosnjeri pat paçënx sa t' mbjithë gjithë këta të përqaşma. Mos shàghet ki lëti, ai kërkoi istorin ton, pjot durime e djers balli.

Ai shkrujti një fjet e re tek historia jonë, me kët shëng na burton ndë një bot, si shkëmbe guri që kan rrënja të thellta, të rëmbiar fortë, ndomos mot i lig, shkundulime dheu, lufta, mot i zi, na rjopen kurrizin, po gjella madhe nëng na ndan, s' bi t' shkollisami ka bota.

Ndë mes t' gjithë shtrenguar, mbajtım gjuhën, pa ditur shkruar e djovasur, miqëria lëtiut, valljet, vjershe, këndima, si "Moj e Bukura More".

E mbi gjithë shëlqen qialli, besë e madhe për Tin Zot e kriqi, unaza jonë, riti i qishës, këndimat e kalimerat e shënjtrave që dhe sot këndomi mbë qishë: "Ati ynë që je ndër qiell u shëjtëroftë ëmri yt, ardhhtë rregjëria jote, u bëftë vullimi yt si ndër qiall ashtu mbi dhe".

Kan mot e vjet që gjithë fjasen për këto globalixaçjona, paqe, vëllezëri, pititi tek i treti dhë, jan fjalë shumë të mbëdhã.

Burri stisi shpi të mbëdhã që ngasen qiallin, udhë ç'ecnjen dheun për së gjati e per së gjeri, mbioj qiallin pjot arjoplpane, thon se van edhe mbalë hënzes.

Po një vend sa t' nxënjen këto fjalë të bukura angò nëng e stisi.

Lexha 482/99 na dha të bëjim dica shurbise, jo shumë, pse ngahërë skollet patin vetim dërrudhez; po edhe me këta pak tures çdo fillele i bëmë. Skolla Parësore e Shën Sofisë që bëri? Nga vit u bënë kursëra e gjuhës arbëreshe për skollëlët, u bënë shumë kërkime e të mbjedhura: fjalë t'urta, parambote, vjershe, fjalë që nëng thuhën më, jatrıt e tatëmadhit, ëmërat e qandave e animalëve, historjet e gjelles të burrave më të nderuar të katundit , etj. Simbjët, tek moj i janarit, bëmë gjithë tabelat që gjënden mbë skollë, dygjuhshëm: ëmërat e kllasave, dalja e emergjences, zyrat, këtu nëng fumaret, hidrant,..... për gjithë Institutin. Gjithë këto i bëmë me turrest e projektit arbëresh që, ë vërteta, janë pak, po, me fuqinë e vullimit, gjë bëhet. Ish mirë ndëse nga skollë bëni këtë, pse ndë gjindia sheh se te skolla arbërishtja është e ndijtur, edhe jashtë pra zënë e e mendonjen ndrıshe e zënë e i japen më rëndësi.



La legge 482/99 ci ha permesso di fare alcune cose, non molte, perché ogni volta le scuole hanno avuto solo molliche, ma anche con questi pochi soldi alcune cose le abbiamo fatte. La Scuola Elementare di Santa Sofia che ha fatto? Ogni anno si sono tenuti corsi di lingua arbëreshe per gli alunni, si sono fatte molte ricerche e raccolte: proverbi, indovinelli, poesia popolare, parole cadute in disuso, le medicine del nonno, i nomi delle piante e degli animali, le storie degli uomini più famosi del paese, ecc... Quest'anno, nel mese di gennaio, abbiamo rifatto tutte le tabelle che si trovano a scuola, bilingui: i nomi delle classi, l'uscita di emergenza, gli uffici, qui non si fuma, l'idrante..., per tutto l'Istituto. Tutto questo l'abbiamo fatto con i soldi del progetto arbëresh, che, è vero, sono pochi, ma, con la forza della volontà, qualcosa si fa. Sarebbe bene che ogni scuola facesse questo, perché se la gente vede che a scuola la lingua arbëreshe è sentita, anche fuori poi cominciano a pensarla diversamente e cominciano a darle più importanza.

Konkors Nacional poezije për Pakicat Gjuhësore

Bashkia e Livinallongo del Col di Lana-s (Belluno) shpalli të trejtin Konkors Nacional Poezije për Pakicat Gjuhësore, i titulluar "Mendranze n poeja", për vlerësimin e kulturavet minoritare të Talljes. Kush do të marrë pjesë, ka të dërgonjë një o, shumë, tri poezi te gjuha minoritare, të pjerra edhe lëtishtë. Çdo poezi ka të

dërgohet në dy kopje daktilografuar ose fotokopjuar, po vet njera ndër ato ka te jetë e nënshkruar me këto të dhëna: gjuha e pakicës, ëmer, mbiëmer, ndiric, telefon, dhe njoftimi se është një poezi e vetja dhe e pabotuar. Me një notë veç, pak lajme biografike. Për të mirret pjesë te ky Konkors s'paguhet faregjë.

Poezitë kanë 'errëjen, mbrënda ditës 31 maj, te ki ndiric: Comune di Livinallongo del Col di Lana, Concorso per Lingue Minoritarie - "Mendranze n poeja", via Pieve, 41 - 32020 Livinallongo del Col di Lana (Bl).

Kryeartikulli

Kosova u ndá nga Serbia

Agostino Giordano

drejtori

Tek festa e madhe e 17 të fjavarit, dita e Pavarësisë së Kosovës “së tij”, mungonij Ibrahim Rugova, Gandhi shqiptar, i cili për më se gjashtëmbëdhjet vjet (1990-2006) qelli përpara luftën e tij paqësore për të bënë botën e tij të pavarur ka Serbët. Si tha një analist ebrë, “Rugova ish si një Mosë, që u end me popullin e tij tue kërkuar pavarësi”. “Një pavarësi e dashur ka populli”, tha kryeministri kosovar Thaçi, ish-komandant i Uçk-së dhe fitues i zgjedhjeve politike të sprasma, tek fjalimi i tij përpara Parlamentit të Prishtinës.

Një akt “i duhur”, që Kosovaret prisnin që ka viti 1999, kur Nato-ja dhe Onu hyjtin tek ish-krahina serbe për të prisnin pastërtinë etnike të programuar ka serbi Miloseviç. Çë, njera tek theristiu i atij viti, kish edhe bënë 10.000 të vdekur, 3.000 të humbur, 20.000 gra të përdhunuar e më se 1.000.000 vetë të nxjerrë jashtë ka shpëtë e tyre. Një mizori që Perëndimi s’mund të duronij, e s’duroi, Dhe Kosova, tek viti 1999, jo vet u shpëtua ka genocidi, ture shkuar nën protektoratin e Onusti; jo vet gjet njetër herë lirinë me ndërhyrjen e Nato-s, po zu edhe e mendoi mbi pavarësinë e saj. Atë që kish sapa shijuar, me Shqipërinë e Madhe, tek viti 1912, kur shpalli për të parën herë Pavarësinë ka perandoria turke.

Sot Serbia proteston, dhe e jëma Rusi me ‘të; flet për drejtësi ndërkombëtare të shkelur; trajton Kosovën akoma si krahinë e saj dhe anulon aktin e autoshpalljes së Pavarësisë. Dhe patriarku ortodoks parkalesën sepse Serbia mos të lëshonjë Kosovën, “zëmbra e djepja” e saj. Po historia na mëson ndryshe.

Alla grande festa del 17 febbraio, giorno della proclamazione dell'Indipendenza della "sua" Kosova, mancava Ibrahim Rugova, il Gandhi albanese, che per oltre sedici anni (1990-2006) aveva combattuto la sua pacifica guerra per rendere indipendente la sua terra dalla Serbia. Come disse un analista ebreo, Rugova era come un Mosè che errò insieme al suo popolo alla ricerca dell'Indipendenza. "Una indipendenza voluta dal popolo", ha scandito il premier kosovaro Thaçi - ex comandante della disciolta UÇK, e vincitore delle ultime elezioni politiche - nel suo discorso davanti al Parlamento di Prishtina riunito in seduta straordinaria. Un "atto dovuto", che i Kosovari aspettavano dal 1999, anno in cui Nato e Onu intervennero nell'ex provincia serba per fermare la pulizia etnica programmata dal serbo Miloseviç. Che fino al giugno di quell'anno aveva già provocato 10.000 morti, 3.000 dispersi, 20.000 donne violentate e più di 1.000.000 di persone costrette ad abbandonare le proprie case. Una barbarie che l'Occidente non poteva tollerare e non tollerò. E la Kosova, nel 1999, non solo si salvò dal genocidio, passando sotto il protettorato dell'Onu; non solo ritrovò la libertà attraverso l'intervento militare della Nato; ma cominciò a pensare seriamente alla propria indipendenza. Quella che aveva appena assaporato, con la "Grande Albania", nel 1912, nella prima

Gjatë gjithë epokës së hekurit, jo vetëm në Kosovë dhe në Shqipëri, po në tërë Ballkaninë, rrojin Ilirët, gjindë autoktonë, të parët e Arbëreshëve. Vet ture u nisur ka shek.XII pas Krishtit (ndonjetër historian flet për shek.VII p.K.) populli zllav i serbëve zu e sundoi pak ngapak këto krahina. Kosova arbëreshe qe, prandaj, e pushtuar ka serbët zllavë.

E tek shekulli i shkuar ky sundim serb u ripropozua nën formën gjeografike e Jugozllavisë komuniste, e krijuar pas të dyjtit luftim botëror dhe e mbajtur shtuara, me pëshitimën. ka karizmi i Titos, dhe pra e rrënuar ka i çmenduri Miloseviç. I cili, ndëse s’kish vatur përpara me “pastërtinë etnike” ndoshta akoma sot Kosova ish krahinë serbe. Për këtë, sot në Bruksel thonë se vetëshpallja e Pavarësisë së Kosovës është një rast “sui generis” në lëmin ndërkombëtar. Mbi këto baz Shetet e Bashkuara e njohtin pavarësinë e Kosovës dhe kështu bënë më të mbëdhentë Shetet të Evropës. “Pavarësia e Kosovës – tha Berisha, kryeministri i Shqipërisë – bën Ballkanët më të lirë dhe më të drejtë”. Dhe kryeministri kosovar Thaçi: “Kosova shpallën zotimin e saj për paqen dhe stabilitetin e krahinës së Evropës juglindor- nënvizoi kryeministri kosovar Thaçi – Pavarësia jonë plotëson procesin e disintegritit të Jugozllavisë”. E ardhmja e Kosovës është mbërnda Ue-së dhe Nato-s. E E udhëhequr ka dora e sigurtë e Amerikës. Dhe mbëllimi me fjalët e presidentit të Shqipërisë, Bamir Topi: “Kjo është fitorja më e madhe e demokracisë në Evropë lindore, që ka rënia e murit të Berlinit”.

autoproclamazione d'indipendenza dall'Impero Turco.

Oggi la Serbia protesta, e la madre Russia con lei: parla di diritto internazionale calpestato; tratta la Kosova ancora come sua provincia e annulla l'atto di autoproclamazione di indipendenza; condanna, destituisce e persegue penalmente le autorità kosovare, democraticamente elette. E il patriarca ortodosso prega perché la Serbia non abbandoni il "Kosovo": suo "cuore" e sua "culla". Cuore e culla di chi? La storia ci insegna altrimenti. Lungo tutta l'età del bronzo e l'inizio dell'età del ferro, non solo in Kosova e in Albania, ma anche nel resto dei Balcani, abitavano gli Illiri, gente autoctona, antenati degli Albanesi. Solo a partire dal XII d.C. (qualche altro storico parla del VII sec.d.C.) il popolo slavo dei serbi iniziò ad occupare progressivamente queste regioni. La Kosova albanese, perciò, fu "conquistata" dai serbi slavi. E nel secolo scorso questo dominio si è riproposto sotto forma di quella "espressione geografica" chiamata "Jugoslavia" comunista, inventata dopo il secondo conflitto mondiale e tenuta in piedi, con lo sputo, dal vecchio carisma di Tito; e poi definitivamente spappolata dall'intraprendente carnefice Miloseviç. Il quale, se non avesse proceduto con la pulizia etnica, nei confronti della Kosova, forse oggi questa sarebbe ancora provincia della Serbia. Ecco perché oggi,

Pashkët 2008 në Kishën e Shën Gjonit të Malvës

Don Pasquale Ferraro

Koordinator kombëtar për baritorinë e shqiptarëve në Itali

Për natën e Pashkëve të këtij viti, bashkësia shqiptare e kishës Shën Gjoni i Malvës, në Romë (Trastevere), po përgatitet të përjetojë një moment intensiv lutjeje: me marrjen e sakramenteve të krishtera, do të bashkohen me komunitetin nëntë katekumenë. Një numër i konsiderueshëm sigurisht, që në vetvete është motiv gëzimi, por ajo që entuziazmon më shumë bashkësinë është se ka arritur të zgjojë brenda grupit dëshirën për t'u takuar e për t'u lutur sëbashku.

Rruga nuk është e lehtë, për motive që dihen, por katekistët përballen me historinë dhe nevojën e secilit, duke u përpjekur që të shprehin gjithnjë ndjenjat e mikpritjes.

Në kishën Shën Gjoni i Malvës përjetohej kjo frymë e qëllimi përfundimtar i sakramenteve arrihet nëpërmjet një rruge, që ndihmon në ripoimin e identitetit si kulturor, ashtu edhe fetar; të qëndrojmë sëbashku në fe do të thotë edhe të kapërcehet ajo ndjenjë e mosbesimit ndaj tjetrit, që e pati shkaktuar në Shqipëri sistemi politik totalitar për gati gjysëm shekulli. Shpirtrat, e pëshjtjelluara nga frika, e nxisnin njeriun drejt individualizmit si shpresë e vetme jetese për të shmangur keqkuptimet dhe paragjykimet mbi personin, sidomos kur ai bënte pjesë në një familje, që dihej se ishte me traditë të krishterë. Prandaj, marrja e sakramenteve nga emigrantët tanë duhet inkuadruar në një kornizë më të gjerë ringjalljeje në shumë kuptime, të cilat veprimtarët pastoralë dhe sidomos përgjegjësit dioqezanë për katekumenët nuk mund të mos i mbajnë parasysh, duke propozuar dinamika pastorale që kanë në qendër njeriun emigrant me prapaskenën e tij të veçantë e specifike historike, me të cilën nuk është gjithnjë i lehtë integrimi në indian e ri shoqëror, e njëkohësisht, duke vlerësuar traditat kulturore të vendit të origjinës që nuk mund e nuk duhet të zhduken, sepse janë pjesë e identitetit personal. Kur ky kujdes ndaj emigrantëve nuk mungon dhe kur kuptimi i krishterë i dashurisë bëhet plan jete për bashkësinë, sigurisht që dëshmia do të jetë pa kufi e pengesa, jashtë skemave burokratike të përcaktuara më parë, që shpesh, siç konstatojmë me keqardhje në punën pastorale të koordinimit kombëtar, shkaktojnë largimin e katekumenëve e jo përfshirjen e tyre brenda bashkësisë.

Gëzimi i krishterë për komponentët e rinj në bashkësinë tonë është festa e Pashkëve të këtij viti, që na bashkon në fenë e Krishtit të Ringjallur e në shpresën, që lind prej saj, për të jetuar e dëshmuar frymën e vëllazërimit në mikpritjen ndaj tjetrit.

proprio per questi motivi – dicono a Bruxelles - l'autoproclamazione dell'indipendenza della Kosova costituisce un caso "sui generis", che non creerà nessun precedente a livello internazionale. Ed è su queste basi che già l'America ha riconosciuto l'indipendenza della Kosova, e lo stesso ha già fatto la maggior parte dei Paesi Europei. "L'indipendenza della Kosova rende i Balcani più liberi e più giusti" – ha dichiarato il premier d'Albania Berisha. La Kosova proclama il proprio impegno per la pace e la stabilità della regione dell'Europa sudorientale. – ha sottolineato il premier kosovaro Thaçi - La nostra indipendenza completa il processo di disintegrazione della Jugoslavia". Il futuro della Kosova è nell'Ue e nella Nato. Guidata dalla mano sicura dell'America. E chiudiamo con quanto dichiarato dal presidente dell'Albania, Bamir Topi: "Questa è la vittoria più grande della democrazia in Europa Orientale, dal crollo del muro di Berlino".

Duhet pak për të kujtomi...

Rino Greco

ka Munxhufuni (Cb)

Ka horët arbëreshe, edhe ndë bëhet shumë për të mbahet gjuha, vuxha ta të vegjet nëng bë të harohet.

Vetëm një djallët, nga dhjetë, flet arbëreshin!

Shum thonjën ke skolla isht vendi ku gjuha ka të mëthohet, gjuha që lexha 482/99 do të vlojë, gjuha që flitëshi ka shpia, ka xhitanija, ajò a gjallta, ajò që eci ndrepur udhvet ta hors, gjuha që flitëshi më shumë ke nani.

Skolla vetëm nëng a mun.

Nëng a mun pse nëng ka gjindë që duhen, nëng do të lodhet pas arbëreshit, fëmjiët nëng mbanjën për gjuhën, ma bë të thomi shumë fjal që biren vetum ma varen e nëng gjëndet mozgjë.

Si ka të bëhet?

Nëng bë të i thuhet mosnjarrive të methoie gjuhën si vet nëng a dishi e të mos veje prapa "gjuhës ta shkëuit".

Na ka të shurbemi ma pak ma ka të shurbemi gjah kur vemi ka midhku, ma një kur a gjata e që bëhet nga dita e jo ma një kur që bëmi lestu lestu e nëng vete mir.

Ka ta mumi, a bërëm shumë herë edhe pa gjithë atò solde që binjen kana drelàrt si shi shumë her derdhen ashtu pa bënur mosgjë o nda bënjën lodhnjën vetum gjindën.

A bëmi ashtu, mirë o keqë, nëng a dimi, të ka ta thonjën turet.

Na pëlqejti të shihjëm një djal, një djallët, një trim që rrui kalëndarin arbëresh (i spasmi ma të voglet e pleqët ta hors), o që erdhi ka Muzeu (Virtual) ka muj gushtit siper gjellës ta arbëreshëvet, o të rruij tre vajzet ta hors Spixan ka Miss Arbëreshe 2007, o ta korsistet ta Korsit Arbëresh që u bëh ka hora.

Nani kapòjtëm vashet e djallëtret ta hors për Kalëndarin-Abetarin ta vitit i re që shurbajtën ma ne.

Trembëdhjetë vashez e dymbëdhjetë djalletre u veshën ma kostumet arbëreshë ta Muxhufunit për të na mësonjën simit gjuhën ta ljoshtëvet ta tone, tre për her, tre për muj.

Qeti një bukur shurbëtir.

Paresu ke duket zëmëra që vurrëm e ke nëng harohet kura gjuha jonë.

Nonostante i grandi sforzi di tutela compiuti nei paesi di lingua arbëreshe per non disperdere il patrimonio linguistico, la voce dei più piccoli è chiara.

Un solo bambino su dieci parla l'arbëreshe!

È viva la convinzione che alla scuola vada riconosciuto un ruolo centrale nella conservazione del patrimonio culturale e della lingua tutelata dalla Legge 482/99, la stessa lingua che rappresentava, prioritariamente un tempo e in modo meno diffuso oggi, il modo di esprimersi dei componenti della minoranza linguistica, cioè, la lingua della famiglia, degli amici, del vicinato, quella viva, quella che echeggiava nelle vie del paese.

Ma abbiamo potuto constatare che la scuola da sola non può.

Potrebbe non avere le risorse o le professionalità necessarie, potrebbe non ritenere valido l'insegnamento della lingua, potrebbe non trovare un terreno fertile a causa del disinteresse delle famiglie alla sua tutela, potrebbe insomma avere mille motivi, tutti più o meno da giustificare.

Ma allora come si fa?

Non si può costringere nessuno ad insegnare l'arbëresh ai propri figli, tantomeno andare controcorrente rispetto all'ondata di linguaggio globalizzato.

Non ci resta allora che tentare...tentare con piccoli gesti, con piccole voci, magari con una cura lunga e costante che senz'altro è più efficace di una cura breve e addensata e evita di non avere come effetto collaterale la "resistenza alla terapia".

Vogliamo provarci, l'abbiamo fatto in mille modi e molte volte anche senza

T' i lash krien pullarit...

Daniela Moccia

ka Shën Benedhiti (Cs)

Ish Shën Benedhit një bibliotekë komunal që kish kaq libra, po që nga shtatë o më vltëra rrij mbullitur e shënbenedhitjotët u kishin edhe harruar se ish një bibliotekë ndë katund. Këtu mbrënda librat fjetin një gjumë i gjatë e ato stesu u kan harruar se ishin ndë një bibliotekë: jo vetëm përçë nëng vej e i gjëj mos njeri për t'i dhjovasi, po më se më përçë më shkoj moti e më nd'atë bibliotekë hijin shërbise që nëng ke të gjënden ndë një bibliotekë, si rrota kamioni e tube të gjata 3 metra e të gjera 30 cm. Pra një ditë një ligje i dha Bashkivet arbëreshe mundësin të kishin një spurtjel gjuhësor, kështu edhe Shën Benedhiti, ca mot dhupo tjetër bashkitë, ndë fund të vitit 2004, hapu spurtjelin gjuhësor ndë sallën e bibliotekës. Operatorët që shërbien ndë të parat gjashtë muaj të këtij shërbimi, përveshtin mëngët e u vun të pullixjarin sallën e të nxirin gjithë ata shërbisë që nëng ke të rrin ndë një bibliotekë: muartin librat, një nga një, i nxuartin një gjishtë purverat, i ndërnuan ture i stajuar për materia. Pra kontrollartin sa libra ishin ndë bibliotekë e sa, megjithëse ishin të regjistruara, nëng gjëndshin më këtëje; ndërnuan skafallet sa të mund hijin libra nga një anë e nga jetra. Kështu qenë dhëmruar afër katër mijë libra e, ndë muajit që qe hapur spurtjeli gjuhësor, shënbenedhitjotët patin mundësin të mirrin hua librat që deshtin. Ndat'ata muaj qenë edhe bjejtur ca libra si ata të Harry Potter, për krjaturat, që janë ata që dhjovasin më shumë Shën Benedhit. Shkuan di vit që spurtjeli funxjonarti kur ëh e kur jo, përçë ndë mest një vit e jetri, Bashkia bi t'e shkuan ca muaj më parë të rinovaj kundratin spurtjelistevet. Nani që ka një motmot spurtjeli gjuhësor nëng është më i hapur e biblioteka e bashkisë jo vetëm është e mbullitur po u pruar të jer një garazh: Bashkia penxoj t'i vëj për mbrënda një makin që pret barët (e gjatë afër 2,5 m e gjerë 1,2 m), dhe një krahë të kësaj makini që besnjën të rëmohet dheu e të mbillet. Po nëng fimrti këtu, përçë është edhe një konje rrulle (i gjerë afër 1,7 m). Është propriu vërtet: «T' i lash krien pullarit libiar motin edhe llisinë!»

Una volta a San Benedetto Ullano c'era una biblioteca con pochi libri, fatiscente e dimenticata, dove parcheggiavano anche ruote di camion e tubi. Poi, con la Legge 482, il Comune di San Benedetto aprì lo Sportello Linguistico nella sala della Biblioteca: perciò questa venne pulita, i libri spolverati, registrati, e la gente cominciò ad usufruirne. Per due anni, a intermittenza, lo Sportello e la Biblioteca hanno funzionato; adesso, non avendo il Comune rinnovato il contratto agli sportellisti, la Biblioteca è tornata ad essere un garage, dove ha trovato posto anche un tagliaerba.

alcuna delle mille e mille risorse finanziarie che scendono a pioggia sulle minoranze linguistiche che invece di "fare centro" si perdono nelle cure forzate senza alcun risultato in termini di tutela, o peggio ottengono l'effetto contrario. Lo facciamo senza pretese...ed arroganza di far bene, questo lo giudicheranno gli altri. Ci è piaciuto semplicemente a volte vedere un bimbo, un ragazzo, un giovane sfogliare un calendario arbëresh (ultimo dedicato ai bambini e agli anziani), oppure lasciarsi incantare guardare incuriosito il museo virtuale dedicato al Ciclo di vita degli Arbereshë (agosto 2007), o ancora veder sfilare tre ragazze del paese nel concorso di Miss arbëreshe 2007 di Spezzano Albanese, o ancora osservare la passione di giovani ed adulti del Corso di Alfabetizzazione nel cimentarsi sui suoni e significati della lingua, ecc....

Questa volta abbiamo scelto i ragazzi e le ragazze del paese per il Calendario 2008, che con entusiasmo hanno accettato di collaborare per la realizzazione di un Calendario-Abbecedario arbëresh.

Tredici ragazzi e ragazze per 12 mesi dell'anno...tredici volti del paese, altrettanti costumi arbëreshë indossati con estrema disinvoltura, quasi per gioco, centinaia di pose e scatti per "alfabetizzare" le pagine mensili dalla prima all'ultima delle 36 lettere dell'alfabeto dei nostri nonni.

Ed è stata un'altra avventura.

Ci auguriamo si possa cogliere l'amore che ci abbiamo messo nel dedicarvi un anno di piccoli gesti e di parole arbëreshë con l'intento di non dimenticare.

Jeta  **Arbëreshe**

Trimestrale di Cultura e Informazione Arbëreshe, in Italia e nel Mondo

Organo dell'Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" di Eianina (Cs)

Direttore Responsabile: Agostino Giordano

Direzione, Redazione, Amministrazione: via G. Marconi, 30 - 87010 Eianina - Purçill (Cs-Italia)
 telefax 0981-32539 / 340-8452364; e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Progetto grafico: Vittorio Giordano

Stampa: AGM, Via Daniel Bovè, 5 - 87012 Castrovillari (Cs) - Telefax 0981.491957

Abbonamenti (6 numeri): per l'Italia € 20 (Istituzioni, € 40), Europa e America € 30

Versamenti: sul c.c.p. n. 12994760, intestato a: Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe", 87010 Eianina - Purçill (Cs) o sul c.c.bancario n. 0300172697 della Banca di Credito Cooperativo della Sibaritide Spezzano Albanese - 87012 Castrovillari (Cs) - Abi 08872, Cab 80670

Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs) n. 4/2001 del 28-12-2001

Articoli, manoscritti e foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono.

Il contenuto degli articoli firmati non impegna in alcun modo la rivista.

Tutti i diritti riservati.

Njeri ka t'i ndihënj Kajvericjotët

Patrizia Figlia

nga Kajverici (Cs)

Turpja bëhet nga dita më e madhe. Bën atë që deshtin pa piejtur mosnjeri, pa thënë gjindjave që ishin e bëjin. Vet nani i sërritët gjith tek Prefeti, që është Soxhëti Atuator¹, të firmarin pameta të ken një shpi që nëng ëshë si i kish qënë thënë. Kishin thënë se katundi i ri ka të vijë si i vjetri, e xha kjo ish një çoti e madhe; ka të vjohëshin udhët e gjitonitë si ishin; shpit ka të kishin gjith vatrën, pse vatra e zjarri bën pjesë nga kultura jonë: ndanë vatrës qellet përpara, ditë për ditë, zakona jonë. Proxheti i këtij katundi bit e ngrëhet leshat nga koca. Shpit janë shumë të keqa, velat (??) të Sekondilanit² janë më të bukura e më të mira. Për Soxhëtin Atuator, Protecjonën Çivile e Kumunin e Qanës, Kajvericjotët ka të jenë edhe kutjend pse këto shpi janë një dhuratë: kajvericjotëvet nëng i toket faregjë, nëng kanë drejtin të kenë prap shpinë që kishin. Pa fjarë nga ata që këtë shpi nëng e dejin që të parin mot. Janë gjind që dërguan lliëra nga një avukat të thojin se shpinë ndë atë katund i ri nëng e duan, e nëng patin mosnjëherë përgjegjje. Nani edhe këta që shpinë ndë Qaneta nëng e duan qen sërritur tek Prefeti për të shihjin si do të jetë shpia e tire. Kta gjind thanë se atje nëng ven e rrinë mosnjëherë: i qe thën se shpitë ja bëjnë, o i duan o ngë i duan. Ndëç mendohet se për çdo shpi venë 120-130.000,00 euro, e se shpitë tek mosnjeri mosnjëherë vete rri janë më se 50, shom se vet për këto shtihen më se 6.000.000,00 euro. Pa folur nga dëmet ekonomike e psikologjike që i bëhen këtime kërshëve që xha patin një shurbes shumë i keq. Njeri ka t'i ndihëj kajvericjotët, ma mosnjeriu i shkon për kocë: janë të lënur te shorta e tire.

La vergogna ogni giorno aumenta. Hanno fatto quello che hanno voluto e adesso hanno chiamato i Cavallerizzoti in Prefettura perché firmino per avere una casa che non è quella che avevano promesso. Avevano promesso un paese uguale al vecchio, con le case, i vicinati, le strade e il focolare. Invece le case sono brutte, ma per Protezione Civile, Prefettura e Comune di Cerzeto, i Cavallerizzoti devono essere contenti perché le case sono in dono, e poi perché non hanno nessun diritto di riavere una casa identica alla precedente. Per non parlare di coloro che quelle case non la accettarono già dal primo momento. Ma i Cavallerizzoti quel tipo di case non le vogliono, e neanche in contrada Pianetta. Ogni casa costa 120-130mila euro, e sono più di 50, un costo (sprecato), quindi, di sei milioni di euro. Insomma, dopo la tragedia, la beffa. Qualcuno aiuti i Cavallerizzoti!

Karnivalli vdiq

Veronica Rovitti

ka Çifti (Cs)

Ndër 4 fjavat, Çivit u bë një rapresentacionë për nderë të Karnivallit. Profesori Vincenzo Bruno shkruajti një Komedje arbëreshe "Proçesi Karnivallit". Ishim katermbëdhjet aktorë, gjithë vashaz: Gazetari (Susanna Di Turi), e para zonjë dhe hjea e saj (Rosanna Miceli e Lucia Piluso), e dipta zonjë (Teresa Bruno), Judhçi (Valentina Filardi), Karnivalli (Silvia Basile), Çotarroni (Maria Pirrone), Posharona (Veronica Rovitti); Verëshitsi, martri (Maddalena Rugliano); Kuoku, martri (Lucia Vincenti); Frutashitsi, martri (Rosalba Palazzo); Krëshmeza (Sandra Pirrone), Ndrükulla (Mariachelli Bellusci), Jatroi (Roberta Filardi), Gjindjat (Mariacarmen Rugiano, Angela Clemente, Lorena Caputo). Rexhia, prof.Vincenzo Bruno e avukati Enzo Filardi; tekniku i mikrofonevet, Vincenzo Rovitti; loxhistikë, Pietro La Cattiva; sekretare, Rosanna La Cattiva.

Qaca Çiftit ish plot, plot me gjind që u mblohtin ka gjithë anët. Më par se të zënjë rapresentacionja, në aktorë, me pakund gjindë të katundit, qelltim rregjin e Karnivallit – ç'ish një papuçull i bënur me kasht (që bëri Pasquale Santoro me t'bilen Teresa) ndëpir

udhit me gëzim e me harë. Ki "Proçes", ç'ju bë Karnivallit, zu tek hera 18,30 njera tek hera 19,30. Kjo komedje dish t'na thonij se Karnivalli pënxon vet t'harë, të pirë e të qeshinj; tjet shurbise s'do t'i dirë. Judhçi djovasi sintenxjen për të kundanamij kët burr, pse qeshi e përqeshi gjindjat e pse gjella tij është si një'ënderr. Kur u firmua Komedja, Gazetari tha: "Karnivalli është simbolli i njëj gjellje të mbrazur!". Gjith rapresentacionja vjen e na thot se një ditë me të qeshur nëng rron përherë! Kur Rosanna La Cattiva presndarti gjith aktorët, spektatorët batuan duart pir pakund minute. Një ringraxjamend i math e applauzet i van autorit, prof.Vincenzo Bruno, pse ai shkruajti kët komedje me zëmer, me amur e pir trimërinë e Çiftit. Më par se t'prirshim ndë shpit, dogjtim papuçullin e Karnivallit e vam e hëngtim gjith të mirat ka Kanonika, ku kënduam e luajtim bashk. Edhe zoti jonë, dhën Andoni Trupo, fametjot, e bëri një tarandelez. Veç kësaj Komedje, Çivit, pir Karnivall, u veshtin krieturt e ca trima, që van ture kënduar me tamurre e me arganeta ndëpir katund.

Libre, Rivista dhe Kalendare

Kalënd(Abet)ari Arbëresh 2008, a cura dell'Associazione Pro Loco Montecilfone (Cb), con il patrocinio di Comune di Montecilfone e Comunità Montana Trigno-Montemauro e la collaborazione dell'Associazione "Kamastra e Qifti Arbëresh".

I ideatur dhe i proxhetartur ka Rino Greco dhe ka pjesëmarrësit e të Parit Kors të "Gjuhës Arbëreshe" të Munxhufunit, Proloku bëri këtë Kalendar/Abetar 2008 e ja dhuroi të rinjvet. Nëndë vashaz e katër guanjùn veshjen kostumet tradicjonale të katundit. Urime!

Kalendari Liturgjik Bizantin-Grek dhe Roman, 2008, a cura della parrocchia di San Giovanni Battista di Plataci, collaborazione di Costantino Bellusci e grafica a cura di Maria Barbara Dramisino. Lajme historikë dhe Liturgjikë mbi Kalendarin Xhulljan dhe Gregorjan dhe mbi Eparkinë e Ungrës. Me fotografi të katundit, pjesa liturgjike, parambote e fjalë t'urta,

lëtisht e arbërisht. Tek e folmja e Pllatnit.

Hylli i Dritës, revistë tremujore themelue në vitin 1913 prej At Gjergj Fishtës, Shkodër, 2007, n. 2 Në këtë numër të revistës së famshme "Hylli i Dritës" gjëmi dy artikuj që kanë interes të veçantë: studiuesi arbëresh Italo Sarro, nga Shën Japku, shkruajti një artikull me titull: "Michel' Angel Calmet eletto di Pulati", një personalitet nga katundi arbëresh Pianiano (Vt); prof. Oliver Schmitt, nga Universiteti i Vienës, boton një studim me titull "Skënderbeu si Aleksandër i Ri. Përvetësimi i traditës së Antikitetit në Arbërinë e Mesjetës së vonë".

D'Angelo Ferruccio, Fiori incantati, a cura di Edoardo Di Mauro, Fonderie Teatrali Limone, Moncalieri (TO), 2007 Është një libër që botoi Komuna e Moncalieri-t për nderë të pitorit arbëresh nga Çifti, Ferruccio

D'Angelo. Libri ka një parathënie të Edoardo Di Mauro-s, i cili flet për artin e këtij artisti ture paraqitur veprat më të bukura, dhe, pas, janë të riprodhuara dica kuadre të tij. Ferruccio D'Angelo (1953) është shumë i njohur si pitur me vlerë artistike, mësemë në Piemonte, ku ai banon që nga shumë vjet.

AA.VV., Studi sull'Europa orientale, a cura di I. C. Fortino - E. Çali, Dipartimento di Studi sull'Europa Orientale, Università di Napoli "L'Orientale", Napoli, 2007

Me rastin e daljes në pension të dica profesorëve (A. Bongo, G. Carageani, C. Nicas, A. Wilkon), Dipartimenti i Studimeve të Europës Lindore i kushtoi një vëllim (ff. 590) me studime të ndryshme që i perkasin gjithë fushës së Europës Lindore. Për botën shqiptaro-arbëreshe shënojm këto studime: 1) "Motivi biblici in "Ruga e Golgotës" di Kasëm Trebeshina" (E. Çali); 2)

"Letteratura italiana in albanese. Percorsi ed osservazioni" (I. C. Fortino); "A proposito dell'albanese "dhelpepoj" (A. Landi); "Botimet kritike në Shqipëri - Misioni i papërmbyhur i filologjisë shqipe" (M. Sauku-Bruçi).

Oriente Cristiano, Rivistë tremujore e Shoqatës Kulturore Italiane për Lindjen e Krishterë, e drejtuar nga dhjaku Pal Gionfriddo, Palermo, viti XLVI (2006), n. 1-4. Ky numër i revistes është një fletore studimesh e kushtuar Atit Gjergj Guxetës, me rastin e 250vjetorit të vdekjes së tij. Është një numër që ka rëndësi të madhe sepse mban një monografi me të gjitha shkrimet, e botuara dhe të pabotuara, që flasën për vdekjen e Gjergj Guxetës. Pra ka edhe një studim me shumë vlerë që shkruajti prof. Vitor Peri, që flet për idealin e njësimi të Atit Gjergj Guxetës për të bashkuar Qishën katolike dhe Qishën ortodose.

Lipet e dimrit

GIOVANNI LAVIOLA
(1915-2008)

Ndër 4 mars 2008 vdiq, Tribizacë (Cs), studjuesi dhe shkrimtari arbëresh Giovanni Laviola. U kish lerë Spixanë tek viti 1915. I laureatur në letërsi italiane, qe profesor dhe drejtor shkollje. Për shumë vjet. Shkruajti edhe një libër rrëfimesh po pra u dha kërkimevet dhe studimevet historikë, aq mbi jetën kalabreze sa arbëreshe. Numri i veprave të tijja është i gjatë; këtu citimi vetëm ata mbi jetën arbëreshe.

Pietro Camodeca de' Coronei, Fabozzi, Roma 1962

Ferdinando Cassiani nel pensiero e nell'azione, Agis, Bari 1970

Società, Comitati e congressi italo-albanesi dal 1895 al 1904, Pellegrini, Cosenza 1974

Gennaro Placco, fiore della prigionia di Luigi Settembrini, Pacini Fazzi, Lucca 1985

Don Paolo Nociti ed i suoi scritti inediti, Trimograp, Spezzano Albanese 1990

Il dramma di una vita: Giuseppe Angelo Nociti, Trimograp, Spezzano Albanese 1991

Le cronache di Vincenzo Maria Cucci (1805-1821), Tnt Grafica, Spezzano Albanese 2000

La Massoneria di Antonio Argondizza, Tnt grafica, Spezzano Albanese 2000

Dizionario biobibliografico degli Italo-Albanesi, Edizioni Brenner editore, Cosenza 2006

Njeri me zëmer të butë dhe kulturë të gjerë, shkoi pjesën më të madhe të jetës së tij ndë mes t'librevet. Edhe ndëse s'shkruajti faregjë në gjuhë arbëreshe, arbërishten e folnij mirë. Çë kur duall i pari numër, janar 2002, i dërgova Jetën Arbëreshe; e kur e gjegja te telefoni, gjë muaj pas, s'mund t'harronj fjalet çë më tha: "E' una cosa meravigliosa". Fjalë çë më nderuan dhe më shtyjtin sa të veja përpara, edhe ato herë kur isha po të lëja. Faqja e tij e qeshme, fjalët e tijja optimiste kanë ' jenë një shembull për gjithë shkrimtarët dhe studjuesit arbëreshë. Veprat e tijja do t'i mësojnë të rinjvet arbëreshë si kërkohen dhe studjohen rrënjët arbëreshe.

(D.)

GIORGIO MARANO*
(1927-2008)

Gjergj Marani lehet ndër 1927, Vakaric (Cs). Hyn te Seminari i Grotaferratës po, pas bombardimevet të rëndë të së dytës luftë botërore, priret ndë katund; mbaron studimet klasikë në liceun e Shën Mitrit Korone; Kosenxë, merr diplomën si mësues. Zë e mëson te shkolla fillore e katundi tij, për 42 vjet. Tek viti 1952 hyn në politikë. Pas tre vjetsh është i zgjedhur kryetar i Bashkisë së Vakaricit. Nën dorën e tij hapet i pari ujësjellës (acquedotto), bëhen kanalet e ujërave të zeza (fognature), bëhen nxilikatat e udhëvet, dritësohet katundi, stisen skollat mëmësore, fillore dhe e mesme. Qe kryetar për 25 vjet. Aktiviteti i tij i gjatë qe i nderuar, ka presidenti Kosiga, me medaljen ari dhe emërimin si Kalor i Republikës.

Mëson gjuhën arbëreshe ndë skollë për tetë vjet, boton dhe shprishen çiklostilate me gramatikë, përrallaz, vjershe, lajme historikë; mësimi i arbërishtit dhezen një zgjim kulturor te gjithë katundi. Shkruan tek rivistat arbëreshe si edhe mbi rivistën shqiptare Dialektologjia Shqiptare. Mbledh, gjatë dhjetra vitrash studimi dhe kërkimi, shumë material historik dhe folklorik mbi Vakaricin, po vdekja e rrëmbje më parë se t'e botonij (ndër 15 të janarit!). Do t'e botonjë Francesco Perri, nxënsi i tij.

Kujtimi i tij do të qëndronjë i gjallë tek sa e njohtin dhe e dishtin mirë. Për thjeshtësinë dhe drejtësinë e tij të kulluar. Një burr çë bëri historinë e Vakaricit, si kryetar e si mësues. Me një fjalë, si mjeshtër. Filozofia e tij jetësore qe ajo e përparimit (progresso) të stisur mbi traditën; ka të ruhet e shkuara e ka ajo ka të mirret fuqia për të vëhet përpara.

* Tekst lëtitsh i dërguar në redaksi ka Francesco Perri, i shkurtuar dhe i pjerrë arbërisht.

Fjalë t'urta e Idjomatizme *

Gjalprit ka t'i bish te kriet
Gur mbi gur bahet mur
I jep doren e të merr krahun
Hekuri shtrambet kur ashtë i kuq
Ka një ferr, një trendafile
Ka trisa mun i nxirsh, ka gjaku jo

Tradita të përllipme

Nicoletta Russo
ka Farneta (Cs)

Grat e burrat albëreshë ja Farnetës s'adoptojnë veshja ndër të zeza të veçanta, po adoptojnë ca "shëngje", çë vëhen mbi veshjen e zakonshme: e veshen pas tet ditë kur thuhet Mesha. Në këtë ndodhje qellet më klishtë rrurët të ziar, çë shkohet gjithëve atire çë gjegjët in Meshan, për shembull të vdekjes e të ringjalljes: ashtu si koqëza grurit mbillet, kalbet, psaj rilehet si kallí, si buk, si gjellë, ashtu Zoti Krisht s'mënd ringjallej ndëse s'kish vdekur. Për shumë mot grat e fëmilës mbajan lipin, e mbajn për gjithë jetan e tire grat çë i vdiq i shoqi: e nxjeran vetë për të vënuri kuror, psana e vëin njatar herë. S'mirrin pjesë tek mos një buthimarë njerëzve, dhe ka e meshuar të shëjtës Meshë, pse të gjëndëshin ndë mes t'njerëzvet ish manganxje nderi ndaj gjiriut të vdekur. Kur andonjari vdisnej, vinej e xëhej me tre të rarë kumborje mbë lip, më parë se të prandonej dialli. Gjithë katundi ish i interesuar dhe tek mos një fëmilë, gjiri o jo asaj ja të vdekurit, mbahshin buthimte mbë haré. Të vdekurin e ruajn gjithë natan një çik për një pothuajse ka gjithë njerëzit e katundit. Lipi gravet e burravet albëresh ja Farnetës është një shëngj: një brez i zi, 5 cm i gjerë, bër me hekuraz me dor, i lidhur si çof në mes ka e djathta, për grat; po për burrat është një kapëshollë e zezë çë vëhet ka kulari këmishës. Belu belu këtë zakonë e lanë. Sod, për vdekjen e njëi gjiriu, vëhet veshja

ndër të zeza e kallavrizvet: e tërë e zezë për grat, skolan për burrat. Me vajtimet klahen të mirat e të vdekurit dhe klahet vdekja tij. Kur priren ka varreza, një grua me një llanxhele mbë dor pret përpara shpis të vdekurit gjithë njerëzit çë kan marr pjesë proçesjonës e përllipëme, për të derdhanj mbi dorës një çik ujë mbë shënj pastrimi. Ai çë merr ujë thot "Nglezot!" dhe emrin e të vdekurit. Mbrëmënet e varrimit, dhe për njëtar di ditë, miq dhe gjiri mbidhen ka shpia të vdekurit për të thon litaní; e për stesu ditë vëhet një qelq ujë, një thel bukë dhe çelet një qiri, pse shpirti çë vdekurit ecën gjithë lloket të rrahu kur ish gjallë: andaj ka duhje për të har, për të pir dhe t'ket dritë. Njetar zakone është të vën ca turre ndir kushelët e vdekurit për të hipanj mbi avullarin e Karontit, të kapircenej lumin Stixhe, për të vej ndë Adin.

Pas gjasht muaj, pas një vit, e kur bie dita ç'vdiq, thuhet Mesha, psaj vëhet në varrezë e çelen qirit. Është edhe e gjallë zakona të kujtohen të vdekurit në muajn e filavarit, javan më parë se Kreshmja, si gjithë katundet çë kan ritin grek; dita e vendosur është e shtuna, "e shtuna përgatorvet", për çdomethënen e vdekjes dhe sakrificit, e pangrënes, e lutjes, të bëra glat Kreshmes, për të ringjallej si Zoti Krisht. E shtuna pas asaj ja të vdekurvet, ja thon "e shtuna shalës" (shalë=coscia,carne): ish

(ec tek faqja 7)

Ka të hash një stupel krip të njohsh një ti kështë

Kau i thot kurnut ghadhurit

Krishti i ban e djallthi i kuqar

Kur të taksnjin derkun, ec me telin

Kur zogu vete e vjen o stisen o ka folën

Kush do të há me dí grik, fukaret

Kush ka millit ngë ka kushall

Kush ngë ka shpi ngë ka mangu gjitoni

Luga, çë e rriminaren, dí sa qiqra ka poçja

Ma mir çot se sindek

Ma i miri mik ti nganon

Mal e mal ngi përpipen

Masu e pra pritu

Mirr të miren kur vjen e të çon, se

e liga ngi mangon

Mjer i zi kush ngë ka njeri

Morrat banjin morra e turrest banjin turrest

Mos qas zjarrin te shtupa

Vorea ghin njera te rrogjèa

(Këto janë të sprasmat Fjalë t'Urta çë Gjergj Marani i dërgoi Jetës Arbëreshe, për botim)

Atë çë shkruajti Gjergj Marani mbi Jeta Arbëreshe :

Mbi mësimin e gjuhës arbëreshe Vakaric, nr.2; Mbi storjen e Vakaricit, nn.4,6,7,16,19; Vjershe popullore të Vakaricit, nn.25, 32, 35, 53, 56; Përrallaz të Vakaricit, nr.29; Fjalë t'urta të Vakaricit, nn. 22, 38, 45, 57;

Tradita të përlipe

(vjen ka faqja 6)

lujtmu ditë që mënd hahej mish. Njerëzit më të bëget, për shpirtin e të vdekurvet ndreqin fukacollet dhe paniqet për të ja jipin atire më të ajlithmonór, që shkojnë shpi për shpi me trasten për t'i kishin. Ai që i mirrnej thoj: "Nglezot të vdekurit e tu". Tek kjo ditë ish mëkat i madh të bëheshin gjith shoq shujbishesh: të shujbejn ka argalia, të bëjn bukët, të punojn dherat, pse kjo ish dita që shpirti të vdekurvet s'mënd vej tue ecur më si doj, se kish të mbidhej ka varri. Për këtë shkak, thuhej: "Gjithë të shtunat ka të vinjan, po jo e shtuna shalës!". Belu belu dhe kjo zakone vate e bjerrë.

 Le donne e gli uomini albanesi di Farneta non adottano un vero e proprio costume di lutto, ma adottano dei "segni" apposti sul costume tradizionale: vengono messi l'ottavo giorno, in cui si celebra la Messa. In questa occasione si usa portare in Chiesa del grano che viene distribuito a tutti i partecipanti, come simbolo della morte e della resurrezione: come il chicco viene seminato, marcisce, poi rinasce come spiga, come pane e come vita, così Gesù Cristo non sarebbe potuto risorgere se non fosse morto. Per un lungo periodo le donne di famiglia portano il lutto, lo portano per tutta la vita le vedove, e solo per le nozze di un figlio lo tolgono, per poi rimetterselo. Non partecipano a nessuna manifestazione pubblica e persino alla celebrazione della Messa, in quanto il fatto di ritrovarsi con altra gente, costituiva mancanza di rispetto verso il congiunto scomparso. Quando qualcuno moriva, il paese ne era avvisato da tre rintocchi di campana suonati a lutto prima che tramontasse il sole. Tutto il paese ne era sconvolto ed in nessuna famiglia, parente o no a quella dello scomparso, si tenevano manifestazioni che avessero carattere gioioso. Il morto veniva vegliato per l'intera notte a turno da quasi tutta la gente del paese. Il lutto delle donne e degli uomini albanesi di Farneta è costituito, per le donne, da una cintura larga 5 centimetri, di colore nero, fatto a mano con i ferri, e legato a mo' di fiocco sul lato destro della vita; mentre per gli uomini è un nastrino di colore nero messo attorno al collo della camicia. Con il passare del tempo questa consuetudine venne abbandonata; oggi, in caso di morte di un congiunto, viene adottato il costume di lutto calabrese: abito totalmente nero per la donna, cravatta nera per l'uomo. Attraverso i lamenti funebri si cantano le lodi del morti e si piange la sua morte. Al ritorno dal

cimitero, una donna con un orciuolo in mano aspetta davanti alla casa dello scomparso tutte le persone che hanno partecipato al corteo funebre per versare loro sulla mano un po' d'acqua in segno di purificazione; e chi riceve l'acqua dice: "Abbi pietà Signore, perdonalo!" accompagnato dal nome del defunto. La sera del funerale, e per altre due di seguito, amici e parenti si riuniscono nella casa del defunto per recitare la litania; e per gli stessi giorni si usa preparare un bicchiere d'acqua, una fetta di pane ed un vero acceso, perché l'anima del morto visita tutti i luoghi in cui è andato quando era in vita, quindi ha bisogno di mangiare, di bere e di essere illuminato. Altra consuetudine è quella di mettere delle monete nella tasca del defunto, perché possa salire sulla nave di Caronte, attraversare il fiume Stige e andare nell'Ade.

Dopo sei mesi, dopo un anno e ad ogni anniversario, si celebra la Messa accompagnata dalla visita al cimitero e l'accensione di lumini. E' ancora viva la tradizione di commemorare i defunti a febbraio, ovvero la settimana prima della Quaresima, come tutti i paesi di rito greco. Il giorno stabilito è "il sabato delle anime purganti", per il senso della morte, del sacrificio, del digiuno, della preghiera fatti durante la Quaresima, per poter poi risorgere come il Signore. Il sabato successivo a quello dei defunti viene chiamato "il sabato della carne": l'ultimo giorno in cui si poteva mangiare la carne. Le persone più ricche, per l'anima dei loro defunti, usavano preparare piccole focacce e piccoli pani, da offrire a quelle persone più povere che andavano di casa in casa con la bisaccia per averle; chi le riceveva diceva: "Abbi pietà, Signore: perdona i tuoi morti". In questo giorno era peccato grave svolgere lavori di qualsiasi genere: fare il pane, lavorare i campi, perché questo era il giorno in cui le anime dei morti non potevano più andare liberamente dove volevano, ma dovevano far rientro nelle loro tombe. Per questo motivo si diceva "Tutti i sabati possono venire ma non il sabato della carne!" Piano piano anche questa consuetudine è stata abbandonata.



Përrallëza e pelës

Mario Massaro

ka Qefti (Fg)

(Këtë prraghzë m'e ka rrëfjetur joshja Lete, e emta tatës, që kur isha djallët e mund kisha tetë o nëndë vjet. Ajo mbrëmten ujëshi torna vrazhërit, plot me karvunelen e djegur; e më rrëfjeji shumë prraghza*.* Ndonjë e mbanj ndër mend mirë, po di tjerat i kam harruar. Nani do t'ju rrëfienj edhe juve "Prraghzën* e Pelës", një fat i vërtet që u ndodh te hora ime shumë mot prapa).

Ishi një herë një burrë që i thojën Ndon, e që kish një pelë për të punonij dheun e tij. Ajo ishi e re e e fort e vetëm me atë burri punoi gjithë dherat që kishi: ai kishi shumë dhera, më ke dhjetë ektare. Një mbrëmë, pas që kish sosur të punonij, Ndoni ju vëh i ngaluar e u pror te shpia. Pela ishi gjithë e dërsitur për shurbëtirën që kish bëjtur tërë ditën, e ajo ditë qeti një ditë shumë e ftohtë, kaq ke bjejen edhe çiqërjelet e borës. Kur erruri te staja, pela u derdh përdhë e ngë duejti të haji mosgjë. Patrui u mbjet lig e u trëmb për shëndetën e pelës. Edhe ditën pas pela ngë duajti të ngrihshi e të haji. Burri atëherë thërriti vetrënarin, po ai ngë mund i bëri mosgjë, pse ajo ishi shumë e sëmur e kishtë pasavisi me pullmuninë. Ndoni e qajti shumë, natë e ditë, pse ngë kishi tjerat animaj që mund e ndihjen të punonij dherat e të bëji çdo tjerit shurbëtirë. Patrui i dishi shumë mirë pelës e kërkoi t'i salvëjti shpirtin e kishtë vajti te privti pse dish i thoji një meshë. Pas që privti gjeji gjithë storjën e kapirti ke burri i dishi shumë mirë pelës, duojti t'e qetësoji e i tha ke mund t'i thuhëshi një meshë e kishtë u morën vesh pse sa grosh Ndoni ki t'i jipij privtit.

Patrui i pelës atëherë i tha privtit ke mund e paguoji te muoji gushtit, pas të shtipurit e grurit. Privti qeti dakord e kishtë të shtunën i tha meshën e kënduor pelës e Ndonit, i cili ngë bëri ke të qaji për gjithë motin që u mbah funxjuna te kisha. Te muoji lujti burri shtipi grurin e bëri edhe shumë; pas e shiti e mori edhe shumë turre, ma ngë shkojti te privti t'e paguoji. Erruri muoji gushtit e privti pa ke Ndoni ngë kish shkuor t'e paguoji e vajti vetë te shpia e tija t'i lipij groshët që kishën kunkurduar i pari ke të thuhëshi funëralli i pelës. E i tha:

- Ndo, ke shtipur grurin, po ngë ke ardhur të më paguoje! Pse?

E Ndoni ju përgjegj:

- Pse do jec paguor? Kur më pasavisi pela, u qajta e ti këndojte e nani do edhe turrest? Ndë ngë vete uz, zë një shkop, të rrjedh pas e të çanj edhe koçën!

E kështu privti shpejt u pror e jiku te shpia e që atë ditë ng'ja lipi më groshët Ndonit.

 * Përrallëz.

(Questa favola me l'ha raccontata zia Amelia Mancini, la zia di mio padre, quando ero ragazzo e potevo avere otto o nove anni. Lei, la sera si sedeva attorno al bracier, pieno di carbonella accesa e mi raccontava molte favole. Qualcuna me la ricordo bene, ma altre le ho dimenticate. Adesso racconterò anche a voi "La storiella della giumenta", un fatto vero che capitò nel mio paese molto tempo addietro).

C'era una volta un uomo di nome Antonio, e che aveva una giumenta per lavorare la sua terra. Essa era giovane e forte e solo con essa il padrone lavorava tutte le terre: egli aveva molte terre, più di dieci ettari. Una sera, dopo aver finito di lavorare, Antonio le si mise a cavallo e tornò a casa. La giumenta era tutta sudata per il lavoro fatto durante tutto il giorno, e quel giorno fu molto freddo, tanto che cadevano anche i fiocchi della neve. Quando giunse alla stalla, la giumenta si sdraiò per terra e non volle mangiare nulla. Il padrone ci restò male ed ebbe paura per la salute della giumenta. Anche il giorno successivo la giumenta non volle alzarsi e mangiare. L'uomo allora chiamò il veterinario, ma egli non poté fare niente, perché la giumenta era troppo malata e così morì di polmonite. Antonio la pianse molto, notte e giorno, perché non aveva altri animali che potevano aiutarlo nel lavoro dei campi e nel fare qualsiasi altro lavoro. Il padrone volle troppo bene alla giumenta e cercò di salvarle l'anima e così andò dal prete perché volle dirle una messa in suffragio. Dopo che il prete sentì tutta la storia e capì che l'uomo aveva voluto molto bene alla giumenta, volle calmarlo e gli disse che le poteva dire una messa e così si misero d'accordo su quanto denaro Antonio avrebbe dovuto dare al prete.

Il padrone allora disse al prete che poteva pagarlo nel mese di agosto, dopo la trebbiatura del grano. Il prete fu d'accordo e così il sabato disse la messa cantata alla giumenta di Antonio in chiesa, il quale non fece che piangere per tutto il tempo che durò la funzione in chiesa. Nel mese di luglio l'uomo trebbiò il grano

(ec tek faqja 10)

Kostumi tradicional i gruas

Kostandin Bellushi

ka Pllatni (Cs)

Kostumi i gruas pllatënjota, si gjithë kunda e tjera i aspetit kulturor arbëresh është shumë i rrallë dhe është nj'shënj soçio-antropologjik të madh edhe nj' identifikim i madh me traditën popullore, dhe kriaran nj' lidhja më të fortë me gjithë diasporan. Ai, veç kësaj, bën të dalë ka kush a veshan, shumë aspekte ç'ndihjan të gjenj hirin, krenarinë, hijen edhe nj'çikë sqimë, që karakterizuar personallitetin poliedrik të gruas orientalle, ç'i pilqen t'trasformar ka nj'soxhet admirimi. Momenti i veshjas ç'shek nj'rituall interesant dhe komplles është i rëndësishëm, dhe duhan shumë përgatitje ç'mbëjan gjall momentin.

Qo çerimonia, nj'herë, ish a bashkuar (ose shoqëruar) me kënga, shumë ndër atë ishan të martesës, të thënura nusas ka mikat dhe ka gjiritë ç'i ndihjan t'vishej, sepse gruaja, njera nd'fund sekullit t'shkuar, martohej me kustumin arbëresh.



Kostumi i martesës ish i bërë me nj'kezë me çofan t'kuqë a mbajtur njera ka moti e llurtmja luftë; ka nj'sqep ç'mbuloni gjithë çeran e nusas: t'dija mbathshin ka kriat. Ndonjëherë ish dhe skamandili karakteristik me thekë. Xhipuni është i qepur me një pilhurë t'hollë damasku dhe i shërbiar me fill llambëdhori me bukurima natyral o me

rillieva ari dhe me fasha me galun ari ka gradha. Për festat t'madha ata ishan bërë edhe me rrobë velluti, t'thjeshtë o t'qindisur me bukurima fantastika. Kta kullura ndrrojan, si ka kustumat e sod, ka kulluri monasaqas a çelët e ka kulluri monasaqas a errët; ka blu i çelët e ka blu i errët. Edhe mëng't ishan të zbukuruar e duarzit me galun t'tjer ari. Linja, a zbukuruar me mbarlleta çë, më shumë se gjithë, i jip hjenë kustumit e martesës, edhe jetrin kostum për ngadita, sod i veshur ka plakat e katundit, ç'ka nj' skamandil t'bardhë, nj' xhipun dhe nj' sutanjel pilhurja me grispa.

Gratë e pamartuara veshjan vetëm sutanielin, po gratë t'martuara veshjan kamizollan a kuqë, kasturinë, o gunën a lehtë o a rëndë, a shërbiar ka argalia, mbi t'çilën vishej coha, a glatë dhe a zgjeruar nd'fund, a paltuar me denduri arrotulla dhe me nj'talun t'gjerë t'qindisur ka palan e poshtme. Kallcjetët ishan t'bardhë dhe me fill mumbaku me xhutaz.

Nd'katund angora kemi kustumin e festës ç'vishat vetëm për dica momenta: për nj'nusa (njëherë dhe për t'vejan pas vdekurit), ka ndonj valla popullore o ka nj'moment kulturor. Kostumi i festës është i bërë ka linja me mbarlleta, ka xhipuni, ka kamizolla dhe ka vandilja me rrëndal o me rikam.

Për plotësimin e kostumit mbahej kalosh nj'mbuluam, me kullur t'kuqë. Kostumi, nd'fund, ka dhe nj'kanakë ari, ka nj'sperëz ari me llacin e zi dhe ka vëthët shikuel.

Il costume femminile platacese, come ogni altro elemento dell'ingente e prezioso bagaglio culturale albanese, ha in sé un grande significato socio-antropologico, rappresenta un'importante identificazione con la propria tradizione popolare e rinsalda un forte legame con tutta la diaspora. Esso, inoltre, riesce magicamente a far emergere in chi lo indossa tanti aspetti che contribuiscono a far cogliere fascino, fierezza, eleganza ed anche un pizzico di vanità, che caratterizzano la poliedrica personalità della donna orientale, la quale adora trasformarsi in soggetto di ammirazione. Significativo è il momento della vestizione che prevede un interessante e complesso rituale, poiché ha bisogno di molti preparativi che ravvivano la circostanza.

Questa cerimonia, una volta, veniva accompagnata da canti, molti dei quali erano nuziali, dedicati alla sposa da amiche e parenti che l'aiutavano ad abbigliarsi, giacché la donna, fino alla fine del secolo scorso, si sposava con l'abito albanese.

Il costume del matrimonio era costituito da un diadema col nastro o il fiocco rosso usato fino all'ultimo periodo bellico; da un velo che copriva tutto il viso della sposa: entrambi si portavano sul capo. A volte si usava anche il caratteristico fazzoletto con le frange. Il corpetto viene confezionato con un tessuto fine di damasco e lavorato con fili d'oro a ornamenti naturalistici o a rilievi d'oro, con fasce di gallone dorato sul dorso. Per le grandi ricorrenze essi

Si foljan të huajt Mashqitë

Giuseppe Chiaffitelli

nga Mashqita (Pz)

Mashqitë, më parë, njera ta a dijta luftë botërore, foljan gluhan arbresh gjithë, kaq mashqitanet sa të huajt. Të parat a foljan se ajo ish gluha atirve e atë vetëm a njihjan mirë; të huajt, dishan o nëng dishan, kish t'a foljan edhe ata, ndë dishan të dëlignonhin ma mashqitanët; e pë këtë, si arrejan Mashqitë, çë nga të parët ditë, ishan shtrënguar të a mbësojan këtë gluhë të panjohur e "të shtrëmbur", si i dukëj atirva. Shumë çë ishan të zgjuar e kishan tru të holla, pas një o di muaj, a mbësojan kaq mirë sa, kur ti i gjegjëja, nëng i zëja pë të huaj, e të dukij sa ata gluhan mashqitanë a kishan pirë ma klumshtin nga sisa së jëmës.

Po ish ndonjë ma trutë ca të trasha çë, edhe pas njëzet vjet, kur folij, ti shumë shpejt ndëligoja sa ai ish i huaj, kaq a shkatarroj gluhan, shtrëmbëj fjalët e i haj bishtin.

A folura lalës Tuçit Klerjas, Dillas Shkapës e ndonjetrit, u mbetë a ndiar e a gjegjur pë shumë mot edhe pas çë ata kishan vdekur.

I pari, lalë Tuçi, një i huaj ardhur nga Forenxa, një burr i vogël ma peprin brënda, u dhezj pë nje mosgjë. Një herë, ta lëmi, si pa se gjithë kishan hipur ta kasaci, domathënë një stave dhamatësh shumë a madhë, e mosnjari u kish mbetur përdhë pë të shtij dhamatat, i tërbuar e i zënë nga volla, u vu të hërrisj si një i llavur: "Ti hip mbi kazac, ai hip mbi kazac, ajo hip mbi kazac, gjithë hip mbi kazac e dhëmât shti krie kar!".

Dialla Shkapës, edhe ajo nga Forenxa, një katund afër Mashqitës, ish a shoqja lalës Mëkellit Shkapës, një burr lesharuq, domathënë ma kurmin të mbuluar ma shumë lesh e qima. Një herë, ta lëmi, flij ma të shoqin brënda kashtës së relës grurit. Rela, a thënë edhe relaturë, isht një grumbull kashtja e gruri edhe të përzjar, çë bëhat ndë mes t'lëmit pas çë u shtiptin ma kuel dhamatat e ka të jetë hjedhur e ndajtur grurët nga kashta ma dhikriënat. Natan vij ngarë e tundur nga krahu të shoqit, e asaj, ca a qëlluar e ca a zgjuar, i dukëj sa ish një gajdhur çë, tura a ngrën kashtan, a tundij. Kur prana u zgjua e ruajt mirë, pa sa ish i shoqi çë i flij pranë. Ditan pas, ja rrëfajti së kunatas e së mbesës Dillinës s'imës emtë. "Moj pupu pupu, motra imë, - thoj ma trëmbësi - mua më duk këmb pullar e ai ish krah Mëkell!".

A Maschito, prima, fino alla seconda guerra mondiale, parlavano l'albanese tutti, tanto i maschitani quanto i forestieri. I primi li parlavano perché quella era la loro lingua e quella solamente conoscevano bene; i forestieri, volenti o nolenti, dovevano parlarla anche essi, se volevano capirsi con i maschitani; e perciò, come giungevano a Maschito, dai primi giorni, erano costretti ad apprendere questa lingua sconosciuta e "strana", come a loro sembrava. Molti, che erano svegli e di mente fina, dopo uno o due mesi, la apprendevano tanto bene che, quando li ascoltavi, non li prendevi per forestieri e ti sembrava che quella lingua maschitana l'avevano succhiata col latte dal seno della loro madre.

Ma c'era qualcuno duro di mente che, anche dopo venti anni, quando parlava, tu immediatamente capivi che era forestiero, tanto guastava la lingua, storpiava le parole e mangiava le finali.

(ec tek faqja 10)

venivano fatti anche in stoffa di velluto, semplice o ricamata con fantasiosi ornamenti, i cui colori variavano, come negli odierni costumi, dal viola chiaro al viola scuro, dal blu chiaro a quello scuro. Anche le maniche erano decorate ed i polsini bordati da altro gallone dorato. La camicia bianca di lino, ornata di pizzi e merletti che, più di tutto, abbelliva l'abito nuziale, continua a corredare anche l'altro costume giornaliero, ancora indossato da poche anziane del paese, che è costituito da un fazzoletto bianco, dal corpetto e da una sottana di cotone o di lino con le crespe.

Le donne nubili indossavano solo la sottogonna, mentre quelle sposate si mettevano la gonna rossa di panno castorino o la sottana di lana grezza, leggera o pesante, lavorata al telaio, sopra la quale si indossava un'altra gonna di seta, lunga e strombata al fondo, con fitte plissettature bordate e una larga trina ricamata all'orlo inferiore. Le calze erano bianche e di cotone, con decorazioni. In paese ancora esiste il costume della festa che si indossa solo in particolari circostanze: cortei nuziali (una volta anche nei cortei funebri), in qualche vallja popolare o altra manifestazione culturale. Esso è costituito dalla camicia bianca col merletto, dal corpetto, dalla gonna e dal grembiule intagliato o ricamato.

A completamento del vestuario veniva portato uno scialle, in genere di colore rosso. L'abito, infine, è corredato dalla collana d'oro, da un medaglione d'oro col laccio nero e dagli orecchini pendenti.

Ritet e marcit

Frangjisk Markianò

ka Spixana (Cs)

Muaji i marcit bie te moti i Krëshmezës e, ca herë, mban edhe Pashktë e, kështu, edhe ritet e traditonat të lidhura këtij moti i madh. Spixanë, megjithse nëng ka më ritin grek që ka viti 1668, mbahen edhe sot ca tradicjona.

Njera ka këto është ajo të priten, tek e para e ënjte të marcit, katër çjerre leshi ka katër anët e kocës ka një grua që njeh racjonën. Kjo, pas që tha uratën, pushtin sipër çjerrevet e i djeg te zjarri. Thuhet se kështu nëng të dhëmbet koca për gjithë vitin.

Njeter tradicjonë është t'i lidhet te puci i kriatruvet një llac i bën me filë leshi me shumë kulture të zdhredhura. Ki mbahet te puci njera kur ng'dhezen furret ku piqen dullçet e Pashkëvet.

Ai vëhet te furri bashkë me taralja, kuljeçe ... Thuhet se siell mirë !

Nga e prëmtë, ndër të tjerat, nëng priten thonjtë, leshtë e ng'prietet mjekra për nderë të Krishtit që ka të vdes. Janë edhe ca veta që nëng hanë mish, e agjëronjën.

Kur ishim të vogla, te moti i Kreshmezës nëng ljuajëm te qindrat e ne vullarjëm kumedhjet, pse thuhej se i cënojëm faqen Zotit Krisht.

Tek e para ditë e Krëshmezës ljuajëm sikur t'ish "pesce d'Aprile", pra kur thuhej e vërteta thrritej: "Krëshmeza!".

Il mese di marzo ricade nel periodo della Quaresima e, a volte, in questo mese capita anche la Pasqua e, quindi, i riti e tradizioni legate a tale solennità.

A Spezzano Albanese, nonostante non si pratichi il rito greco dal 1668, si mantengono alcune usanze rituali.

Una di queste è quella di farsi tagliare, il primo venerdì di marzo, quattro ciocche di capelli dai quattro lati della testa da una donna che conosce l'orazione. Questa, dopo aver recitato la preghiera, sputa sopra le ciocche e le brucia nel fuoco. Si dice che tale pratica non faccia venire il mal di testa per tutto l'anno.

Un'altra usanza è quella di legare al polso dei bambini un laccetto fatto di fili intrecciati multicolori di lana, chiamato Marzo. Questo si terrà al polso fino a quando non verranno accesi i forni, dove saranno cotti i dolci tipici della Pasqua. Eso verrà messo nel forno assieme a taralli, ciambelle, etc... Si dice che sia un gesto beneaugurale.

Ogni venerdì, inoltre, non si tagliano le unghie, i capelli e né si rade la barba per rispetto a Gesù, prossimo alla morte. Ci sono persone che non mangiano carne, facendo astinenza.

Quando eravamo bambini durante il periodo della Quaresima non si giocava alla lippa e né si libravano gli aquiloni, perché si diceva che si faceva male al volto di Gesù.

Il primo giorno di Quaresima si faceva un gioco simile al "pesce d'Aprile" però al momento di svelare la verità si gridava: "Quaresima!".

Vjershet e Maqit

Ndreu Bellucci

ka Maqi (Cs)

Si qandez te stamaqi m'u qandove, shture rrënjat e zëmren m'e ngave; e ndë m'e ngave ti dërgome thënë e mos bën të rri me këto penë.

(Come piantina nel petto mi ti sei piantata, / gettasti le radici e il cuore mi toccasti; / e se me lo toccasti tu mandamelo a dire / e non farmi stare con queste pene)

Shkova një herë e di ksaj gitonjë e pe një vashëz që më rrij mbë hje; me buzë mbë gaz më bëri mbë si: më tringllisi zëmra kur e pe.

(Passai una volta o due da questo vicinato / e vidi una ragazza che stava all'ombra; / colla bocca sorridente mi fece l'occhiolino: / mi tintinnò il cuore quando la vidi)

Ti je e vikerr e u për tia vdes, ne mund të runj ne mund të fjas;

buza më qeshen e zëmra më qan: ç'i bëra Krishtit e më dha këto penë?

(Tu sei piccola e io per te muoio, / né posso guardare né posso parlare; / la bocca mi sorride e il cuore mi piange: / che cosa ho fatto a Cristo e m'ha dato queste pene?)

Ti je e bukur si një fill kurala e je si molla kur më nxiren lulen; donja t'inja trim si ti kopile, se kado venja të dërgonja te fala.

(Tu sei bella come una catenina di coralli / e sei come melo quando fa sbocciare il fiore; / vorrei essere giovane come te giovinetta, / ché dovunque andrei ti manderei saluti)

Me ghust e afecjonë ktejna vinj e shpirtit ndë vdes ktejna shkon; e zëmra ngë më thot të të lirenj se fort afecjona më shtërngon.

(Con gusto e affezione di qui passo / e l'anima, se muoio, di qui passa; / e il cuore non mi dice di lasciarti / ché forte l'affezione mi stringe a te)

M'u shkreh nj'illith i kuq e më ra mbë truall:

ndë të mundnja, vashë, të ngrënja ndër qiell;

se je e ëmbel si një mastacuall, andajna vinj këtejna për tina, diell.

(E' esploso una stella e m'è caduta in terra: / se potessi sollevarti, ragazza, ti alzerei al cielo; / ché sei dolce come una mostarda, / per questo passo di qua, per te, o sole)

(1 – ka më)

Festa e Shumburjes

Luciano Chiarello

ka Puheriu (Kr)

Ka një par dit, te hora e Puheriut kan zon praparativet për festin e Shumburjes e Karminit, një festë që puherist ndienjin shumë e që bonjin mirë nga vit, pse e bonjin me zömarin. Simbjeta festa është u 10, 11 e 12 e Majit, ma të parat rriuniona ka komitati kan qonë te të parat ditët e Marcit. Festa ngë është sughu te atë tre dit, psë ze 9 dit mo para kur ze "Novena", e te ktà vjet prapa kisha ka qon e piot nga mbroma me gjindje që kan gjegju meshin e pra kan kindua novenin për Shumburin. Pra, dín e festes, Shumburia vjen e qehtur për horin e shtu gjith e shohnjin që shkon hppara ders, i ndienjin kuvertat mo të bukura ka barkuni, si bohej një herë, e i shtinjin fjetat e lulvet, roza mo shumë se gjith.

Për festin, si nga vit, shumë puherizara, që jan të partirma te atri hora, ntëhen Puheri, ku jan lerë, pse gjith puherist jan shumë të dhilura te Shumburia, kan bon vut e i mbanjin shumë. Festa e Shumburjes e Karminit që bohet Puheri është njo ka mo të bukura ka gjith xona, e shumë veta ka iert hora ndandis vinjin Puheri kur është festa, që është nga vit shumë e bukur, purqen gjithve e le nteri gjith gjindjet shumë kument.

Për gjith ditët e festes, pra, hapet një merkatin, që vjen i thon "Il Mercatino della Solidarietà", pse sordet që nkasaren vinjin gjith të dhona gjindjet që ng'kan nente e rrinjin te Afrika e dësnjin ka piti. Te ki merkatin shiten kai koza që bonjin gjindjet ka Puheriu, shumë koza të bona te hekurat o të qepura. Ashtu vinjin të ndihura veta që rrinjin mo lik se neve. Pse për neve është festë, ma puru kur ng'është fest rrimi mir lu stesu; kta gjindje ng njohnin festa, shumë herë manku hanjin, e rrinjin lik.

Da un paio di giorni a Pallagorio sono iniziati i preparativi per la Festa della Madonna del Carmine, una festa che i Pallagoresi sentono molto e che organizzano bene ogni anno perché lo fanno col cuore. Quest'anno la festa ricorre dal 10 al 12 Maggio, ma le prime riunioni del comitato si sono tenute nei primi giorni di marzo. La Festa non consiste solo in quei tre giorni, ma inizia 9 nove giorni prima con la Novena, e negli anni passati la chiesa è sta gremita ogni sera di gente, che ha sentito la messa e hanno cantato la novena per la Madonna. Poi, il giorno della festa, La Madonna viene portata in processione per il paese e così tutti la vedono passare davanti alla porta di casa, espongono le coperte più belle al balcone, come si faceva una volta, e le gettano i petali dei fiori, rose soprattutto. Per la festa, come ogni anno, molti Pallagoresi residenti in altri paesi, vengono a Pallagorio, dove sono nati, perché tutti i Pallagoresi sono molto devoti alla Madonna del Carmine, hanno voto voto e ci tengono molto. La Festa della Madonna del Carmine che si fa a Pallagorio è una delle più belle di tutta la zona e molti dagli altri paesi vicini vengono a Pallagorio il giorno della Festa, che da anni è molto bella, piace a tutti e lascia tutti molto contenti.

Per tutti i giorni della festa, poi, si apre un mercatino, chiamato "Il Mercatino della Solidarietà", perché i soldi che si incassano vengono tutti donati alle persone che non hanno niente, stanno in Africa e muoiono di fame. In questo mercatino si vendono tante cose che fa la gente di Pallagorio, fatte con i ferri o cucite. Così vengono aiutate persone che che stanno peggio di noi. Perché per noi è festa, ma anche non è festa stiamo bene ugualmente; questa gente invece non conoscono feste, molte volte neanche mangiano e stanno male.



W ARBITALIA .it
W
W .net

Teatër Arbëresh

Sharamiku e martesë Ballabanit

(komedje në 4 akte)

Llinuçi Mastrafellit (Lino Mitidieri)

ka Purçilli (Cs) – (1937-2001)

(vjen ka nr. 56)

Akti II

Shena III

(Personaxhe: Sharamiku, Ballabani, Markuri)

Mark.: Jam e ngurem, e vete mbjonj gjith plasim, sepse kam bes se me se ndonjeri do t'frihet gas!

Shar.: Ec e i hrrit Bularit, t'hash, se striatij s'rri mirë!

Mark.: (ture i vënur nëmë) Kish t'i bijë ajo e liga!...

Shar.: Ec, t'hash, e mos bir mot! (E shtin)

Mark.: (Ture dalë) Jam e vete, jam e vete! U zgurdartit vërteta e përgjithmonë!...

Ballabani: (pra që Markuri duall) Njeter çik e i shtros'sha, e bë t'shijhe si i dridhja kriet!...

Shar.: Për paq Krishtit, zoti Ballabà, rrini kuët, mos gjithësej vete mbë rrotull!..Em rrimi qetu se jan e priren...

(ka më)

Shena IV

(Personaxhe: Bulari, Markuri e ata ç'ishen)

Bulari: (Hin te shena, me Markurin pas) Nji si është ki kund? Si qe? Nani atej rrinej mirë, s'kish faregjë!

Shar.: Ç'duni se ju thom... u, i nëmuri proksenit? Kin e dini më ju ç'jini jatrua: ruanie mir mir e shihni!

(Ndërsa Bulari zë e vizitaren Ballabanin, jasht shenes, zë një muzk e ëmbel: është kënga e Vjershtarvet)

Shar.: Dil e ec i thuaj t'e sosjen, sepse striatij është sëmur e s'gjegjen: mëndaj, pidirka se i bëjen sirinaten!...

Mark.: (ture dalë) Kish mund ' pjasnej!...

(Këndimi firnon, Markuri priret te shena; ndërkaq edhe Bulari firnon së vizitarturi Ballabanin)

Shar.: Ç'ka? Ç'i gjet'it?

Bul.: Me!...T'folenj dreq: ktij u s'i gjeta faregjë! Mund jetë aq nj'tok dhi guç sa nj'mininxhit...sa mund jetë nj'amnezë o një t'ratë trushi... S'di ç'kam thom!...

Shar.: Ndëlemni, zoti Bulà, po më fjandasen se ju dini njeter aq sa di u!...

Bul.: Rrëmbi jatrisë ka rrënj të thella, miku im, e dicaherë duhen studime shumë të gjetë se t'errësh t'kuptosh shurbise që, ati për ati, duken...Jo, ka t'jetë, pa thënë, njera ndir ato smundje ç'duan mot se t'i studjosh...

Shar.: Zoti Bulà, ju folni shumë ngusht e u s'kapirta faregjë, po dua t'di vet ndëse striatij mund harë.

Bul.: Mund harë gjithësej.

Shar.: E poka, ndërkaq...ç'ju ven e studjoni ç'ka, ti Markur ec e i mirr t'harë strisë tij...

Mark.: Pse, edhe ka t'harë? Nji s'është sëmur?

Shar.: Pse, ti ke bes se ata ç'jan smurë s'hanë? S'e gjege zotin Bular? Ec, t'hash, e mirr t'ngrenit për strinë e tij! E bëj karrera!

Mark.: Ndëse ai s'pipen, mund e di u ç'djallin do t'harë?

Shar.: Ec e mirr çdo është: mish pulje, mish kunilli, shtjerri, lepuri; o ç'djallin t'vjen ndër tru. Më shpejt, bëj karrera, sepse kam bes se i vjen u.

Mark.: Zë e kam bes se ti Sharamik ke më pak kujdes për pjënsin tënd se për atë t'atij nuni ç'ke mbanë!

Shar.: Mbulli at buz, t'hash! E e mirr t'ngrenit, se striatij ka t'harë!

Mark.: (ture dalë) Kish t'hanëj rrënjën e kangaresë!...

Shar.: E gjejt, zoti Buà? Ësht pa rëspjët...për zotin e tij!...

Bul.: E gjege, e gjege! E ku e dimi ndëse kam i jap tort... Ballabani s'është shumë i ëmbel me sherbëtoret e tij. E nani jam e dal edhe u: më pëstaj prirem e shoh ndëse i lipset gjë. (del)

Ball.: (pra që qindruan vet, ai e Sharamiku) M'kish ardhur ngullia t'i çaja gradhen t'dive!...

Shar.: Jo, kin rrini pa pipur! Kini paq, zoti Ballabà, nëmos shularet gjithësej, e atë ç'bëm njera nani vete mbë rrotull!... Ju e thash!...

Ball.: (i matur) Sa ke t'bësh për vashzen e zëmres!...

Shar.: E di edhe u, zoti im: për kët kund s'dua t'martohe!.. Po rrimi qet... se është e vjen Markuri.

Përrallëza e pelës

(vjen ka faqja 7)

e ne fece anche molto; poi lo vendette e guadagnò anche molti soldi, ma non passò dal prete per pagarlo. Venne il mese di agosto e il prete vide che Antonio non era passato a pagarlo e andò lui stesso a casa sua per chiedergli i soldi che avevano concordato prima che si dicesse il funerale della giumenta. E gli disse:

- Antonio, hai trebbiato il grano, ma non sei venuto a pagarmi. Perché?

E Antonio gli rispose:

- Perché vuoi essere pagato? Quando mi morì la giumenta, io piansi e tu cantasti, e adesso vuoi anche i soldi? Se non te ne vai, prendo un bastone, ti corro dietro e ti rompo anche la testa!

E così il prete subito si voltò e se ne andò a casa, e da quel giorno non chiese più i soldi ad Antonio.

Si foljan të huajt Mashqitë

(vjen ka faqja 8)

La parlata di zio Antonio Clelia, di Domenica Scappa e di qualche altro è rimasta famosa e ascoltata per molto tempo, anche dopo che quelli erano morti.

Il primo, zio Antonio, un forestiero venuto da Forenza, un uomo piccolo col pepe dentro, si accendeva per un nonnulla. Una volta, nell'aia, come vide che tutti erano saliti sul "casazzo", cioè una bica di covoni molto grande, e nessuno era rimasto a terra per lanciare i covoni, adirato e preso dalla collera, si mise a gridare come un ossesso: "Tu sal su casaz, lui sal su casaz, lei sal su casaz, tutti sal su casaz e covon lanc cap de ...!".

Domenica Sc'cappa, anche lei da Forenza, un paese vicino a Maschito, era la moglie di zio Michele Sc'cappa, un uomo peloso, cioè col corpo tutto coperto di molti peli e lanugine. Una volta, nell'aia, dormiva col marito dentro la paglia della "reglia" del grano. La "reglia", detta anche "regliatura" è un mucchio di paglia e grano ancora uniti, che si accumula in mezzo all'aia, dopo che si sono trebbiati con i cavalli i covoni, e deve essere ventilato e separato il grano dalla paglia con i ventilabri. Durante la notte veniva toccata e mossa dal braccio del marito ed a lei, tra sonno e veglia, le sembrava che fosse un asino che, mentre mangiava la paglia, la smuoveva. Quando infine si svegliò e guardò bene, vide che era il marito che le dormiva vicino. Il giorno seguente lo raccontò alla cognata ed alla nipote Domenica, mia zia: "Ahimè, sorella mia, - diceva con paura - mi sembrava gamba puledro e quello era braccio Michele!".

PAJTIM NË
JETA ARBËRESHE
+
FJALOR
i Emanuele Giordano-s
40 EURO

Lutjet e hilnarit

pruar arbërisht protopapasi **Emanuele Giordano**

frasnjot, prifti i Purçillit

I - O Zot i butë, lipisjar e zëmërgjerë, mblidhe lutjen tonë e gjegje thirrjen e lutjes sonë. Buthtona një shenjë mirësjije, drejtona tek udha jote, se t'ecmi tek e vërteta jote. Gëziona zëmrat tona tek trëmbësia e ëmrit tënd të shëjtë, sepse ti je i madh e bën mërekul; ti vetëm je Perëndi e mosnjë ndër perënditë të gjet tij, o Zot, i fuqishëm në lipisi e i mirë në fuqi; ti ndihën, ti ngushëllon e shpëton gjithë ata që shpresojnë tek ëmri yt i shëjtë. Se tij të nget çdo lavdi, nderim e adhurim, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

II - O Zot, mos na dënò në zëmërimin tënd e mos na ndëshko tek mëria jote; po qellu me ne sipas lipisisë sate. Ti jatrua e shëronjës i shpirtit tanë, udhëtona te porti i dëshiravet të tua, dritësona sytë e zëmrvet tona, tek njohja e vërtetës sate; e bën se pjesa e kësaj ditje, që na qëndron, të shkonjë mbë paqë e pambëkat, si edhe gjithë moti i jetës sonë; me lutjet e Hyjindësës së shëjtë e të gjithë shëjtravet. Se yti është pushteti, dhe jotja është rregjëria dhe fuqia e lavdia, e Atit e Birit edhe e Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

III - O Zot Perëndia ynë, kujtohu për ne mbëkatarë e shërbëtorë të tu të pavlerë, kur thërresmi ëmrin tënd të shëjtë dhe të adhurueshëm, e mos na turpëro ndërsa presmi lipisinë tënde; po dhurona, o Zot, gjithë atë që të lypmi për shpëtimin tonë, dhe bëna të denjë të të duami mirë e të të trëmbemi me të tërë zëmren tonë, e të bëjmë, në të gjitha, dëshirën tënde. Se ti je Perëndi i mirë e që do mirë njerëzit, e tij na të drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

IV - O ti, që je i kënduar nga fuqitë e shëjta me himne të pandërprerë dhe me lavdërime të përmonshme, mblo buzët tona me lavdinë tënde, se të madhërojmë ëmrin tënd të shëjtë. Bëna të denjë të marrmi pjesë në trashgimin e të gjithve atyre që vërtetë të trëmben e ruajnë kumandamentët e tu; me lutjet e Hyjindësës së shëjtë e të gjithë shëjtravet të tu. Se tij të nget çdo lavdi, nderim dhe adhurim, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

V - O Zot, o Zot, ti që mban të gjitha në pëllëmbën e dorës sate të tërëdëlirë, ti që ke durim me ne të gjithë e që mërihe për veprat tona të liga, kujto mirëdashjen e lipisitë e tua. Vizitona në mirësinë tënde dhe jipna neve, të shpëtomi, me hirin tënd, në pjesën e kësaj ditje që na

qëndron, nga pajidhet e ndryshme të të Ligut; dhe ruajna jetën tonë të shëndoshtë, me hirin e Shpirtit tënd të tërëshëjtë. Për lipisitë e njeridashjen e t'yt Biri të vetëmlindurit, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin tënd të tërëshëjtë, të mirë dhe jetëbërës, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

VI - O Perëndi i madh e i çuditshëm, që drejton gjithë me mirësi të pathënshme dhe me providencë dorëgjërë; që na dhe të mirat e dheut, dhe, tue na dhuruar hirin, na dhe një kaparrë të rregjërës që na takse; dhe na bëre të denjë, në pjesën e ditës që shkoi, të mund të lllargohëshim nga çdo e keqe, jipna, edhe për motin që na qëndron, të dalmi të drejtë përpara lavdisë sate të shëjtë, se të të himnojmë tij, të vetmin Perëndinë tonë, të mirë dhe njeridashës. Se ti je Perëndia ynë dhe tij të dërgojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

VII - O Perëndi i madh dhe shumë i lartë, ti je i vetmi i pavdekshëm e që rri te një dritë e paafreshme; ti me dituri plazmove çdo krijesë; ti ndajta dritën nga errësira, e vure diellin se të zotëronij ditën, dhe hënën e yllit se të zotërojin natën. Ti na bëre të denjë, neve mbëkatarë, të vijim përpara teje edhe te kjo herë të të falënderojmë dhe të të dhurojmë lavdinë e mbrëmjes. Ti vetë, që do mirë njerëzit, drejtò lutjen tonë posi livan përpara teje e mblidhe si erë e këndshme. Bën se kjo mbrëmje, edhe nata që qaset, të shkojnë në paqë; veshna me armët e dritës, shpëtona nga trëmbësia e natës dhe nga çdo gjë që ecën në errësirën; dhe jipna gjumin, që ti krijove si prëhje të ligështisë sonë, të lirë nga çdo ankth i djallit. Ëh, o Zot i madh, dhënës i të miravet, bën se edhe mbi shtretat tanë të të thërresmi të penduar, dhe të kujtojmë ëmrin tënd natën; dhe jipna se, të dritësuar nga mejtimi i kumandamentëve të tu, mund të ngrëhemi me zëmër të gëzuar se të lavdërojmë mirësinë tënde, tue i sjellë bujarisë sate thirrje dhe lutje për mëkatet tanë e për ata të tërë popullit tënd. Vizitoe me lipisi, për lutjet e Hyjindësës së shëjtë. Sepse ti je Perëndi i mirë e që do mirë njerëzit; e na tij të dërgojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

*) Te Mbrëmësorja e Madhe, ndërsa djovaset psallmi 103, prifti, shtuara përpara ikonës së Zotit Krisht, e me zë të ulët, djovasën Lutjet e Hilnarit.

Qisha dhe jeta arbëreshe

Arbri Roman

ka Roma

Tre miqtë arbëreshë u përpoqin te der'e qishës të shtunën mbrëma. Si nga herë u ultin tek një shkallun dhe foltin për të rejat nga Arbëria. Ata rrojnë Romë, po kanë trutë te katundet tanë.

Gjergji, qaniot ka Hora e Arbëreshëvet, tha se ndë Siçillje jan'e organizojnë një kongres mbi një kallogjer nga Grottaferrata, ç'u kish lerë te hora e Kuntisës. Ai qe mjeshtër i njohur muzike. Shkruajti kënga qishje që këndohen edhe sot ndër Arbëreshët.

"Bëjnë mirë, shumë mirë – tha Kozmai – duhen kujtuar ata që bënë mirë për jetën arbëreshe; duhet t'i jipet zëmër të rinjëvet për të jenë krijues në kulturën arbëreshe".

"Si bëhet se çdo hërë që flitet për kulturën arbëreshe, flitet për priftra?" – pyejti Ndoni ka Ruri.

Ju përgjegi Gjergji: "Kjo është historia jonë. Katundet tanë ishin të vogla edhe në dhe të huaj. S'kish shkolla, dhe ato ç'ishin bëshëshin ndë gjuhë lëtishte. Një, për të bënë priftin, ka të studjonjë, si mundën. Tek na Mesha thuhej greqisht, dhe prifti duhej të studioj greqishten; prifti duhet të flitj me popullin që flisin arbërisht dhe duhej të mësoj mirë arbërishten. Kështu bëri Luka Matranga ka Hora, i cili shkoi Romë te Kollegji Grek sa të studjoj e pra, si u pruar te katundi i tij, shruajti katekizmin arbëresh për popullin me titullin "E mbësua me e krishterë" (1592). Qe i pari libër arbëresh. Pra priftrat mësuane edhe kënga arbëreshe, sa t'i këndojnë lutjet t'Ynë Zoti. Kështu u mba e gjallë gjuha jonë. Praktika fetare ruajti traditat kulturore arbëreshe".

"Është vërtetë – ja ngjati Kozmai ka Strigari – Edhe në Kallabrje i pari libër i shkruajtur që bërë nga një prift poet, ja thojn Jul Variboba. Ai mblodhi kënga popullore, por shkruajti edhe një poem mbi "Gjellën e Shën Mërisë Virgjër" (1792). Ai përdori ritme poezije dhe fjalë të marrë nga populli, kështu që populli i mësoi njize e mirë dhe ja shkoi gjeneratavet të reja, ç'i këndojnë edhe sot. Këta kënga shkuan nga pleqët të rinjvet, trazmetuan fjalë, voka, shprehje, ndjenja. Formuan një traditë arbëreshe dhe pleqët me ata shkuan fëmijvet dashurinë për jetën arbëreshe".

"Jo vetëm – tha Ndoni ka Ruri – Ndë Kallabrje e ndë Siçillje priftrat krijuan dy Kollegje për Arbëreshët. Ata qenë vatra e kulturës arbëreshe. Atje studjuan priftrat, po, por edhe laikë që mbajtjin të gjallë kulturën arbëreshe dhe e rritëtin me forma të reja, si dej moti. Mua më duket - mori fund Ndoni – më duket, thom, se Qisha ndër Arbëreshët, qe mëma e popullit: na dha qumësht e bukë. E krypë për kryet".

Tre amici, come al solito, davanti alla Chiesa bizantina di S. Atanasio, si incontrano e parlano sulle novità dell'Arbëria.

Giorgio, da Piana degli Albanesi (Pa), racconta che nel suo paese stanno organizzando un convegno su un monaco di Grottaferrata, nato a Contessa, autore di musiche cantate ancora oggi tra gli Arbëreshë.

Cosmo, da San Cosmo Albanese (Cs), ribadisce che è giusto onorare chi ha lavorato per l'Arbëria, perché sia di esempio e di sprone ai giovani arbëreshë.

Antonio, da Ururi (Cb), si chiede perché ogni volta che si parla di cultura arbëreshe, si parla di preti. E Giorgio gli risponde che questa è la storia arbëreshe. Nei paesi arbëreshë la Messa si diceva in greco e il popolo parlava in albanese, quindi il prete doveva imparare greco e albanese. Così fece Luca Matranga da Piana, che studiò nel Collegio Greco a Roma e poi, tornato al suo paese, scrisse un Catechismo Arbëresh (1592) per il popolo: fu il primo libro arbëresh. I preti insegnarono anche canti in onore di Dio e dei Santi. E così si mantenne viva la lingua. La pratica religiosa conservò le tradizioni culturali arbëreshe.

Cosmo assentisce, ricordando a sua volta come anche in Calabria il primo libro scritto in arbëresh fu quello di un prete-poeta, Giulio Variboba, che scrisse "La Vita della Madonna" (1792), usando poetare e lessico popolare, e il popolo lo imparò a memoria, e ancora oggi ne canta brani interi. Di generazione in generazione si è trasmesso, attraverso questi canti, l'amore per il mondo arbëresh. Antonio ricorda infine che proprio in Sicilia e in Calabria i sacerdoti costruirono due Collegi per gli Arbëreshë, dove studiarono sia preti che laici, che insieme mantennero viva nel tempo la cultura arbëreshe. E conclude dicendo: "La Chiesa è stata una madre per il popolo arbëresh".

Djovasni

Jeta Arbëreshe on-line

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Bukuria e tmerrit

Ali Podrimja

poet e shkrimtar nga Prishtina (Kosove)

1 Shpesh kam qenë në Palermo. Sepse ishin dhe arbëreshët. Sa herë shkëlja në këtë qytet, kisha ndjenjën e frikës; ballafaqimin me ndonjë fytyrë, që e kisha parë në ekran apo lexuar diku në libra. Vendosesh në një hotel pranë hekurudhës. Mendoja se do të më shpëtonte zhurma, që më bënte t'i vëja tapat në veshë. Më vonë kuptova se ishte rrenë dhe qyteti nuk kishte ngjashmëri me filmin e tmerrit. Epiteti i frikshëm, i tmerrshëm, i përgjakur, i ankthshëm, qytet i mafisë, më bukur i rri ndonjë kasabaje ballkanike. Palermo nuk është qytet i tërmeteve, i gjarpërinjve, siç flitej. Imazhin e tij e dëmtuan regjisorët e pandërgjegjshëm që kërkonin irrealen.

Ngjashëm më ndodhi dhe mua “në mes të gjithë atyre kufomave” tek shikoja një palë sy lëvizës të një fëmije të balsamuar në Katakombet e Kampuçit, kisha derdhur lot dhe mezi kisha dalë nga një labirinth tmerri, ku bukuria e syve të fëmijës së balsamuar më kishte shtangur; para meje qëndronte trupi i pajetë, që kishte diçka të veçantë.

Në marramendthin tim zbulova dhe shtegun, ku mbrëmjeve shëtiste shkrimtari i famshëm italian, Leonardo Shasha. Ishte parë edhe Santanxhelo, një poet fin, i cili që në vitet e shtatëdhjeta shkroi poezi për Kosovën e që m'i recitonte Zefi ynë. Gjarpërores deri në Horën e Arbëreshëve, më bëhej se njëqind vjet ngjitesha. Kur fiku makinën para një pllake të mermerit, më kishte pyetur për filmin “Nuni” të Kupolos me Marlon Brandon në rolin e Don Vito Korleones. Mes të tjerash, i kisha thënë ka ngjashmëri aty me odat tona, veç dhoma e grave dhe veç ajo e burrave, pastaj kallaballëku. Pas pak më rrëfeu historinë trishtuese të asaj shtëpie, që nuk e keni parë në filmin e Kupolos.

2 Pas Mazzaro del Valos e takimeve të tjera, Palermo më bëhej se gumëzhinte aty buzë Erenikut. Karadakliu më tha dikur se këtë qytet e paska shkëlur para nesh Plaku i Vlorës. Ç' ishte më befasesue, ne banonim në të njëjtin hotel, në të njëjtën dhomë, ku kishte bërë gjumë ai. Me siguri ka fjetur në shtratin tim, njerëzit e mëdhenj nuk i lanë afër dritares, i thashë. Karadakliu më foli edhe për rrugën të cilës ishte ngjithur me suitën e vet deri në Horën e Arbëreshëve. Nga të dy anët numri i arbëreshëve kishte qenë tepër i madh, nga dalja e Palermos e tejart gjarpërores. Në të

vërtetë, ky më fliste për rrugën, që e kisha shkëlur edhe në ëndërr; se gjërat që zbulohen rastësisht, ato mishërohen me ty dhe vështirë të shkëputesh nga hija e tyre.

Mbasi banonim në një hotel aristokrat, kisha kujdes të mos e ndotja imazhin historik. E kisha lënë Palermon të zgjohej vetë me atë bukurinë e llahtarshme, siç do të thoshte Lasgushi. Dhe sapo gjendeshim tek kreshta historike nga ishin nisur Garibaldi me poetin tonë, Francisko Krispin, të mposhtnin Mbretërinë e Napolit, nën rrëzën e frikshme të malit, veneronim trupin e qytetit si notonte mes Ujit të Madh. Prapë e kishim zënë ngoje iluzionin e Naim Frashërit në poezinë për Krispon. Dikujt iu kishte kujtuar dhe koha e shtatë pashallarëve, kur Mesdheu ishte në dorën tonë. Po tani: historia është e tmerrshme kur popujt nuk e gjejnë veten në hapësirë e kohë. Dhe për gjithë atë rrugëtim kisha kërkuar fjalët e mundshme: E largët dhe e lartë, ku njerëzit bëjnë punë zotërash. Kështu e shihja Horën e Arbëreshëve dhe njerëzit e saj.

3 Do ta shohim Leonardo Shashon? Edhe pak gjendeshim te shtegu i humbur në blerim. Ora soste me të shpejtë natën. Shkaku i harresës Njeriu që nuk dinte të buzëqeshë, u zgërdhi. Në hotelin paska banuar dhe Ismail Qemajli, i tha Karadakliu. Ai prapë u zgërdhi, ashtu siç na kishin thënë, halabakët dhe iku dikur pa na thënë si ia luajti një hienë mesjetare. Nga një dokument i gjetur rastësisht e i cili u shpëtoi tërmeteve, thuhet se shqiptarët e pushtuan për herë të fundit Palermon kur zbuluan se deti kalohet edhe këmbëkline.

Tek dëgjoja Karadakliun mbi hienën dhe trimin e përrallave, shikoja faqen e malit të mistershëm si zbardhej. Kisha vërejtur ca gropa të zeza për të cilat Zefi na tha se ngjarje të dhembshme kishin ndodhur aty. Unë nuk besoja se trupi i balsamuar i një fëmije me sy lëvizës në Katakombet e Kampuçit tregonin diç tjetër.

Gjendesha në një labirinth magjik. Palermo ishte afër e tepër larg njëkohësisht; i ngjante frymëmarrjes së femrës, që pret të zgjohet në takimin e ardhshëm. Një valë rrenuese përplasej për brigjet, por syri lëvizës i një fëmije ishte bukuria që më bëri ta kafshoj dhe tmerrin.

Nuk di, e dëgjon kush dhembjen...?

Bilota i shkruan një litër De Radës

Italo Costante Fortino

nga Shën Bendedhiti (Cs), Universiteti l'Orientale i Napolit

Si u vlua dhe u zhvillua kultura arbëreshe ndë të shkuarën, mund t'ë ndojmë edhe ture dhjavesur atë ç'i shkruajmë njerëzit njerëzit që mirreshin me probleme të jetës së arbëreshëve dhe të kulturës tyre. Kështu nga litrat që një shkrimtar i dërgon jetrit, na mund të ndojmë se si sillshin e si shërbenin arbëreshët e shekujvet të shkuar e që vlerë i jipnjin problemevet të jetës së çdo dite njerëzit e popullit, por edhe ata që, si shkrimtarët, popullin e mësonjin dhe i buthtonjin udhë të rea.

Këtë herë ju flas për një litër që shkrimtari Bernard Bilota i shkruan Xhirolam De Radës ndë vitin 1896, që revista “Jeta Arbëreshe” boton thomse për herën e parë. Këtë litër e fotografoi d.sha Zaira Toçi, nga Ungra, këtë verë, kur vate sa të studhjonij dica dokumente te Biblioteka Rregjorore e Kopenagenit. U e haristisij për se m'e dha t'ë botojmë te revista “Jeta Arbëreshe”.

Çë thotë kjo litër? Pak shërbise të jetës të çdo dite, por janë shërbise që mund t' na interesojnë. Litra flet për një të mirë që De Rada i lipi Bilotës e që Bilota në fund, kur De Rada kish bjerrë sprënxën, ja bën e i shpjegon si vate shërbise.

Na mund nxjerim dica përfundime të thjeshta por domethënëse:

1. del nga litra se Bilota e nderonij shumë De Radën dhe e konsideronij si një Mjeshtë të vërtetë. Për këtë i vëhej në dispozicion si një shërbëtor; dhe ndihej i nderuar t'ë ndihmij.

2. megjithëse De Rada ish Mjeshtëri i nderuar, dhe mandaj kish shumë autoritet, mbani lidhje shumë familjare mësemë me ata që bashkëpunonin me të. Kjo afëri del edhe nga kjo litër kur De Rada haristisij me ironi Bilotën se nëng i kish bërë atë ç'i kish kërkuar, e Bilota i përgjegjet ture i shkruar se fjalët e tija e kishin llastimisur një cik.

3. Ndë fund Bilota i thotë hapët se nëng mund të shkruanij më shumë, pse kish të venij ndë Qishë. Kjo bën e ndojmë sesa Bilota ish i lidhur me shërbiset e Qishës e se për Qishën shkurttonij edhe litrat.

4. Na gjithë dimë se aq De Rada sa Bilota janë shkrimtarë të famshëm në arbërisht, por gjithë shkëmbimi i litravet, si edhe kjo litër që mund t'ë dhjavasni këtu poshtë, është ndë gjuhën lëtare. Vjen me thënë se ndikimi i lëtitshes ndë të shkruarit ish i fortë edhe nd'atë mot.

Njo, këtu poshtë, testi i litrës që Bilota i dërgon De Radës.

* * *

Frascineto 9/96

Veneratissimo Sigr. Maestro,

Non ho potuto servirvi prima, perché la roba non era pronta. E' roba casalinga che costa, e non di quella vendereccia. Costa a tre carlini il braccio - sono dodici braccia - perché persona amica mi ha agevolato a ben servirvi. Nel caso non vi piacesse pel prezzo, non già per la qualità, che è ottima, potete rivoltarmela. Perdonate l'espressione. Parlo così per farvi intendere che vi ho servito meglio che volessi servire gl'interessi miei. Il vostro biglietto di visita mi ha sconfortato, ringraziandomi di non avervi servito, mentre non è mancato per me ed io aveva del desiderio di servirvi e come mio maestro e come persona degnissima d'essere servita non solo da me, sebbene anche da persone di grandi meriti. Comandatemi per quanto posso servirvi. Dove non posso, come mi compatisce Iddio, così spetta pure a voi.

Non mi trattengo a parlarvi delle altre cose, che più interessano le nostre occupazioni, perché devo recarmi in Chiesa.

Baciandovi la destra, vi prego vogliate credermi pel vostro più affezionato servo ed amico

Bernardo Arc. Bilotta

JETA ARBËRESHE

(6 vitra: 2002-2007)

56 numra, 896 faqe, kulturë e lajme ka Arbëria

250 euro

(për Istitucionat 400 euro)

“Autobiografia e popullit në vargje” dhe poezia arbëreshe

(Recension librit të Ismail Kadare-së, “Autobiografia e popullit në vargje”,
Tiranë, Onufri, 2002)

Edmond Çali

shqiptar, lektor i gjuhës shqipe, Universiteti i Napolit L'Orientale

1. Gjithë letërsia shqiptare është një sistem. Falë strukturës së këtij sistemi të gjitha pjesët e tij kanë vendin e vet brenda sistemit. Pjesët e sistemit janë të lidhura dhe bashkëplotësojnë njëra-tjetrën. Një nga këto lidhje është lidhja midis tërë letërsisë shqiptare dhe letërsisë arbëreshe. Kjo duket qartë edhe në lidhjen midis veprës së Kadaresë dhe letërsisë arbëreshe.

Në librin e tij “Autobiografia e popullit në vargje” Ismail Kadare i kthehet disa herë temës arbëreshe. Fillon në pjesën e gjashtë, ku krahason Ciklin Arbëresh me Ciklin e Veriut. Pastaj në pjesën e dhjetë kur analizon rëndësinë e malit për njeriun shqiptar. Në pjesën e njëmbëdhjetë mbështetet në faktorin arbëresh për lashtësinë e ciklit epik shqiptar karshi epikës sllave. Merr në shqyrtim poezinë arbëreshe kur shkruan për marrëdhëniet e shkrimtarëve shqiptarë me poezinë gojore në pjesën e katërmëdhjetë dhe e mbyll në pjesën e pesëmbëdhjetë, ku gjysma e saj, është një nga kalimet më të larta letrare kushtuar arbëreshëve.

2. Fillojmë me citimin e kësaj pjese të fundit:

“Me këtë traumë në kokat e tyre, rreth njëqind mijë shqiptarë, ajka e vendit, ata që kishin bërë epopenë, pasi kishin lënë brigjet e vendit të tyre, duke mos e përfytyruar dot jetën nën mynxyrën osmane, po iknin përtej detit, në Evropë. Dhe kështu u vendosën në një pjesë të Italisë, të mbetur pa atdhe, ata që kishin pasur një nga atdhetë më të vjetër në botë. Është vështirë të merret me mend pikëllimi i tyre, përgjumja shpirtërore në mëngjesin pas natës së ankthit e të delirit, rreziku i rënies në apati, në fatalizëm, në përhumbje” (f. 166).

Kjo ishte gjendja por “Në këto çaste të vështira u erdhi në ndihmë poezia. E përkorë dhe fine, e përndritur nga lotët, e pandryshkëshme, si një grumbull brilantësh e stolish, ajo u shkund midis atyre shpirtave të vranë, duke marrë përsipër të bënte të pamundshmen, të kthente atë që dukej e pakthyeshme; të ngjallte Shqipërinë së vdekuri. Ishte ky një pretendim titanik që asnjë shkollë letrare, asnjë manifest kulturor s’do të guxonte ta merrte përsipër, por që ajo, e druajtura në pamje, e bukura, e përkora, arriti ta bënte. Në ca lëvizje vallesh të lehta, si lëvizje shpirttrash, nisën të skicohen të mjegullta imazhet e atdheut, në ngjyrat e veshjes, në ninullat e djepit e sidomos në baladat, që ata nisën t’i rikujtojnë, t’i shtojnë e t’i rikrijtojnë me një mall të madh, me tërë gulçin që shkaktonte humbja e të dashurit, që, në këtë rast, ishte si nënë e babë, si vëlla e motër, si fëmijë e nuse, ishte si të gjitha këto e më shumë se këto, sepse qe atdheu i tërë. Kjo largësi, ky mjegullim gati i ëndërrt i atdheut, i dha tonin dhe stilin gjithë poezisë popullore arbëreshe. E gjithë ajo ishte një synim, një zgjatje krahësh drejt diçkaje, një zgjim me një shpresë dhe me thyerjen e saj gjër në mëngjesin tjetër, një ‘sikur’ i madh (sikur të vinin prapë atje, sikur osmanët të treteshin një mëngjes, sikur Shqipëria të ringjallej!)” (ff. 166-167). Kadare saktëson: “S’është e rastit që kënga kryesore e arbëreshëve u bë balada e Kostandinit dhe e Doruntinës. Atë e këndonin ose e vallzonin në mbremjet e festave të tyre. Ajo, me atë valavitje midis jetës e vdekjes, me atë pandehje, me atë realizim të së pamundurës, ishte më afër se çdo gjë tjetër me gjendjen e tyre shpirtërore” (f. 167).

Dhe e mbyll kështu: “Fenomeni arbëresh është një nga ata më të rëndësishmit e historisë sonë kombëtare. Atje u vunë në provë të gjitha: kujtesa e kombit, gjuha, arti, poezia e tij. Të tjera përjetime e prisnin në të ardhmen vendin e lashtë të arbrit, të tjera drama. Në to, ashtu siç s’mbeti pa u përzier e pa u përzhitur asgjë, u përzie e mori pjesë edhe arti i tij. Por ai e kishte tashmë një siguri për t’i përballuar të gjitha. Dhe i përballoi...” (f. 167)

3. Ismail Kadare duke analizuar sistemin poetik popullor dhe unitetin e tij vë në dukje një “laryshi të pashembullt”. Bën krahasimin e Ciklit të Veriut me Ciklin e vjershave dhe valleve arbëreshe. Cikli i Veriut është “I rëndë, me një dritë të ftohtë, ka të gjitha gjurmët e kohës kur është krijuar ose përpunuar. Koha e krijimit të tij është e gjatë dhe shtrihet para dhe pas pushtimit otoman. Pikërisht kjo shtrirje në kohë, ka bërë që në këtë rapsodi të gjejmë ndërthurje nga më të ndryshmet, duke filluar nga finesa alpine, gjër te brutaliteti mesjetar. Ndihet prania e pushtuesit të egër. Ndihet menjëherë që vendi është ashpërsuar. Rrjedhimisht, është ashpërsuar edhe teli i lahutës. Këngët janë vende-vende të zymta. Krahas dritës alpine, zanave shtojzavalleve, krushqve e orteqeve të lbyrtë, ndeshim në shtegtime mercenarie, mallkime ogurzeza, zinxhirë burgjesh, pabesi dhe tmerre” (f. 46-47).

Cikli arbëresh ndryshon: “Poetika e arbëreshëve është tepër e hollë dhe fine. Duke qenë kryesisht pjellë e jetës shqiptare para pushtimit otoman, ajo ka

Poezi Arbëreshe

UL KRÍTË

Çë ndihe i madhë
e bëhe zot me ato
më të vabëga se ti,
kur kukulushohe
ul krítë e vriy nj’aj
përdhë e pas, ndë
të ngrehtër lipu
çë je e kush je.
Mbaje ndë mendje
e mos harrohu njera
se nëng vdes: i madhë
është një vet.
Ato çë bëhen të madha
me të voglët, lart dhe
Zot ç’është ndë qiell
nëng i sheh.

Giuseppe Gallo
ka Shën Marcani (Ta)

ABBASSA LA TESTA – Perchè ti
senti grande / e ti fai il signore con
quelli / più poveri di te, / quando ti ac-
covacci / abbassa la testa e guarda un
po’ / per terra e dietro, e nel / rialzarti
chiediti / cosa sei e chi sei. / Tienilo a
mente / e non dimenticartene fino / al-
l’eternità: grande / è uno solo. / Quel-
li che si fanno grandi / con i piccoli, in
alto / il Signore che è nei cieli / non li
considera.

pasqyruar gjendjen e vendit tamam
në atë fazë të zhvillimit të tij. Prej
kësaj poezie është e lehtë të
kuptohet që populli ynë në atë kohë
ka qenë mjaft i kultivuar në
krahasim me shumë popuj të tjerë të
zonës mesdhetare. Zakonet, sjelljet,
manierat e tij ishin të përpunuara;
në jetën e tij kishte mjaft frymë
kavalereske, me një fjalë, vendi ynë
ishte një vend i kulturuar evropian
për kohën.

Ky realitet i kohës
paraskënderbeje, i ruajtur me
dashuri prej arbëreshëve të
shpërngulur nga atdheu, i filtruar
gjatë shekujve nëpër një avull të
përhershëm malli mjegullor për
atdheun, që u mbeti pas detit, ka
krijuar atë klimë të freskët të
poezisë arbëreshe, një lloj klime
livadhi, gjithë kaltërsi, ozon e
pikëllim fin” (f. 46).

4. Kadare paraqet tezën se
marrëdhëniet e shkrimtarëve
shqiptarë me poezinë orale kanë
qenë gjithmonë aktive: “ato kanë
qenë raporte afrimi e jo largimi.
Shkrimtarët arbëreshë Gavril Dara e
De Rada u shquan ndër të parët për
këto raporte të ngushta. Një pjesë e
veprës së tyre është njëfarë
bashkëpunimi me muzën popullore
por në një mënyrë krejtësisht

IMAZHE

Nd’isha një
kërkoja një kroj
nga i cili të mburoja ftohtë e çë
shuon etje.

Nd’isha varë
Kërkoja dega
Të tundra në dritën e menatës.

Nd’isha një yll
Kërkoja një qiell
Ku të virsha për Ë shkëlqej
E të llambarisja mbë botën.

U po jam një burrë
Dhe kërkonj rrënjët e mia,
djeshmen time, shkëmbin e fort
mbë të cilën ka të shënonjë sodmen
pë të projektojë të nesërmen.

Rrëmoj origjinat e mia
pë t’ja trashgonjë
Njerzëve çë, nesër,
vërtet gja u,
ka të kërkonjë rrugën e tyre.

Antonella Massaro
ka Qefti (Fg)

IMMAGINI – Se fossi acqua / cerche-
rei una fonte / dalla quale zampillare
fresca e dissetante. / Se fossi vento /
cercherei rami / da dondolare nel chia-
ro del mattino. / Se fossi una stella /
cercherei un cielo / a cui aggrapparmi
per brillare / e splendere sul mondo. /
Io però sono un uomo / e cerco le mie
radici, / il mio ieri, roccia forte / sulla
quale incidere il presente / per proget-
tare il domani. / Scavo le mie origini /
da tramandare / a uomini che, domani,
/ proprio come me / ricercheranno la
loro via.

krijuese, duke u mbështetur në
frymën e saj, pa përdorur formulat
apo grupet e formulave të
mekanizmit popullor, pra, duke
ruajtur përherë pavarësinë dhe me
synimin e qartë për t’u ngritur mbi
nivelin e poezisë orale” (f. 162).

Në një vështrim të përgjithshëm të
marrëdhëniet të traditës popullore
me veprën e shkrimtarëve shqiptarë
vëmë re se këta e kanë shfrytëzuar
traditën në mënyrë krijuese. Kadare
dallon dy grupe: disa shkrimtarë si
De Rada, Çajupi, Poradeci dhe Noli
u ushqyen prej traditës në mënyrë të
drejtpërdrejtë, kurse disa të tjerë si
Naim Frashëri, Migjeni dhe
shkrimtarët e Realizmit Socialist në
mënyrë të tërthortë.

5. Në pjesën e dhjetë të librit, duke
folur për rëndësinë e maleve në

(ec te faqja 15)

Kosova, nga parahistoria...

prof. dr. sc. Zef Mirdita

nga Universiteti i Zagrebit

(vjen nga nr.56)

Këto veprimtari ekonomike kanë qenë karakteristike për luginën e Prizrenit dhe të Pejës, për çfarë na flasin edhe mbeturinat e materialit vendbanues në fshatrat Mushitishtë, Studençan, Torazhdë, vendbanime në mes Prizrenit dhe Suha Rekës, Bërnjaç, Rudnik, Ilixhe, vende në mes Pejës dhe Mitrovicës së Kosovës si dhe përgjatë luginës së Drinit të Bardhë te Dobruzhda, Vlashnja, Nasheci në afërsi të Prizrenit si dhe Xërkses, Doblbares, Bërdosanes, Ratkovci dhe Dërsnikut të Poshtëm, të gjitha në hapësirën në mes të Rahovecit, Gjakovës dhe Klinës.

Kurse në Rrafshin e Kosovës, përveç bujqësisë që ka ndikuar në ngritjen e vendbanimit të tipit "gradina", kanë vazhduar të rrojnë edhe më tutje, siç janë në Drenicë, Lab dhe vende të tjera. Gjithësesi edhe burimet termale kanë ndikuar në ngritjen e vendbanimeve, si Ilixha e Klllokotit te Vitia e Kosovës, Ilixha e Pejës që është e njohur me emrin Thermidava dhe ajo te Malisheva në rrugën nga Dulja në drejtim kah Rahoveci.

E tërë kjo ka ndikuar në zhvillimin e rrjetit rrugor. Nëpër territorin e Kosovës së sotshme në antikë ka kaluar magjistralla transballkanike Naissus-Lissus, e cila te Vicianumi, te fshati i sotshëm Çagllavicë, 3 km në jug të Prishtinës, është degëzuar në dy drejtime. Njëri ka shkuar nëpër Ulpianë për në Scupi dhe Thesalonike, kurse tjetri nëpër Therandë te Prizreni i sotshëm, Gabuleum te Kukësi i sotshëm në Shqipëri e më tutje.

Përveç kësaj magjistraleje transballkanike, kemi edhe viae vicinales, rrjetin aneksor rrugor e cila lidhte brendësinë me qendrat municipale. Një rrjet të tillë rrugor na vërtetojnë edhe kërkimet arkeologjike, siç është ai pranë luginës së Ibrit, që lidhte këtë territor me Adriatikun dhe rruga që shkonte nga Foça nëpër Plavë dhe te Theranda lidhej me magjistrallen Naissus-Lissus. Kjo rrugë te Gradishtit, respektivisht te ura e Fshajt mbi Drinin e Bardhë, lidhej me rrugën aneksore që shkonte nëpër fshatrat Radost, Ratkovc, Damjan, Çiflak, Kramavik, Klinë, pra bregut të majtë të Drinit të Bardhë. Nga Klina drejtimi ka shkuar në verilindje nëpër Drenicë dhe Rrafshinën e Kosovës, kurse te Vicianumi lidhej me trasenë Ulpiana-Municipium DD.

Një rrjet i këtill i rëndësishëm rrugor flet për zhvillimin intenziv të jetës ekonomike, për çfarë flasin stacionet doganore, respektivisht Portorium Illyricum, nëpunësit e së cilës janë quajtur conductores dhe vilici. Stacione të tilla janë dëshmuar në Runjevë te Kaçaniku, Llapna Sello, 7 km në jug të Prishtinës, Batushë te Fushë Kosova, pranë të cilit ka qenë njësia ushtarake për mbrojtje, në Gushtericë të Poshtme dhe Turigevc (në Drenicë).

Sidoqoftë, megjithatë, këtë hapësirë nuk e rroku urbanizimi. Përveq qendrave municipale, Ptolomeu përmend edhe Arribantion-in që

mund të lokalizohet te fshati i sotshëm Binçë te Vitia e Kosovës. Nga ana tjetër, vendbanimet që përmenden bashkë me magjistrallën transballkanike Naissus-Lissus janë me karakter staciones apo mansiones, siç janë Vindenis te vendi i sotshëm Gllavniku te Podujeva, Vicianum (Çagllavica), Theranda (te Prizreni) dhe mutationes, siç është Vellanis te Prishtina e sotme dhe të tjerë.

Përveç formave të cekura të veprimtarisë ekonomike, në antikë në këtë vend ka qenë i zhilluar zanati , siç është vorbëtaria, argjendaria e të tjera. Edhe pse këtu ndjehet ndikimi i zanatit romak, prodhimi i karakterit lokal është më se i qartë. Tradita lokale qartë shihet në format dhe dekorim, ashtu siç shihet qartë në stolitë e arit me xhevahirë dhe me pasten prej qelqi (në Vindenis), diademat ("Prisojë" te Soçanica) e të tjera.

Jeta intenzive dhe ekonomikisht e pasur ka ndikuar jo vetëm në shtresimin shoqëror por edhe në lulëzimin kulturor. Kështu në qendrat municipale ka ekzistuar edhe një jetë e pasur kulturore, si teatri, që qartë shihet nga maskat teatrale të gjetura në Ulpianë.

Një aspekt i caktuar i romanizimit ndjehet jo vetëm në urbanizim dhe në infrastrukturën e tij por edhe në jetën religjioze. Do thënë se kultet epihorike dhe hyjnitë vendas janë ruajtur edhe në kohën romake të cilët nëpërmjet "interpretatio romana" janë inkuadruar në panteonin romak. Nga këto hyjni epihorike në "interpretatio romana" duhet të përmendet Andinus-i (Kaçanik, Vushtri), Jupiter Melcid (Ulpiana), Dea Dardaniae (Smira te Vitia e Kosovës), ndërsa prej kulteve romake janë të njohur Jupiter Capitolinus, Triada e Kapitoliane (Jupiter, Junona me Minervën), respektivisht Jupiteri, Herkuli dhe Neptuni, shembuj të papërsëritshëm në tokën Ilire; pastaj Minerva, Neptuni, Merkuri, Fortuna, Nimfa, Silvani dhe Silvana, Genius Illyrici si mbrojtës i stacioneve kufitare.

Prej kulteve lidnore janë dëshmuar kulturi i Dolihenit, Mitrës, Serapisit, kurse prej atyre thrakë Zbelturdi (Kaçanik, Vushtri, Banjskë te Mitrovica e Kosovës), "Kalorësi thrakë" dhe "Kalorësit të Pellgut danubian" (në Studençan te Suha Reka).

Në trevën e sotshme të Kosovës nuk është e pranishme në mënyrë të vazhdueshme as një formacion i ushtrisë romake, edhe pse në mbishkrime janë dëshmuar veteranët leg. IV Flavia dhe leg. VII Claudia.

Kriza që në shek. III-të pas Kr. e kishte kapluar Perandorinë Romake nuk e anashkaloi as Illyricum-in. Reformat e Dioklecianit, më vonë edhe ato të Konstantinit të Madh, janë ndërmarr me qëllim të ruajtjes së unitetit të Perandorisë Romake. Kanë qenë bazë e organizimit shtetëror të perandorisë deri në rënien e saj.

Në këtë veprimtari reformative, në vitin 297 pas Kr., për të parën herë Dardania përmendet

si njësi provinciale më veti.

Krizat politike do të reflektohen edhe në jetën ekonomike dhe në raportet shoqërore. Në këtë kanë ndikuar edhe invadimi i barbarëve, nga njëra anë, dhe zvogëlimi i popullatës, nga ana tjetër. Meqenë se xehetaria gjatë kësaj krize, veçanërisht në shek. III dhe IV pas Kr., edhe më tutje ka qenë njëra prej degëve më të rëndësishme të përfitimit dhe ka pasur qëllimin e ruajtjes dhe shërimit e të ardhurave perandorake, ajo edhe më tutje ka mbetur në duart e perandorit. Mirëpo, ato i kanë udhëhequr procuratorët të zgjedhur nga rendet e kurialëve, siç mund të shihet edhe në bazë të ediktit të perandorit Teodoz nga viti 386 pas Kr. Për shkak të dobësisë gjithnjë e më të madh të jetës ekonomike, veçanërisht bujqësisë, për tu ruajtur fuqia punonjëse, kolonët dhe inkvilinët me edikte të ndryshme perandorake e kanë pasur të ndaluar që ta braktisin tokën dhe zotërinjtë e tyre. Përveç kësaj, tregëtia bie, që qartë reflektohet edhe në zanat. Objektet luksoze të metalit kryesisht janë prej bronzit, siç janë fibulat (Soçanicë, Ulpianë) e të tjera.

Për dallim nga vendbanimet e tjera urbane jeta e të cilave shuhet në këto kohëra të pasigurta, siç është rasti me Municipiumin DD, Ulpiana zhvillohet në një prej qendrave të rëndësishme të Dardanisë. Ajo, si edhe Municipium DD, nuk dallohet nga qendrat e tjera urbane të Perandorisë Romake. Këtë e vërtetojnë mbeturinat e forumeve, tempujve, kanalizimit, termeve, bazilikave.

Termeti katastrofal që e goditi Dardaniën në vitin 518 pas Kr. ndër vendbanime të tjera e ka shkatërruar edhe Ulpianën. Perandori bizantin Justiniani (527-565), për t'i ruajtur kufijt e Perandorisë Romake nga invadimet e fiseve barbare, por edhe për t'i ripërtërirë vendbanimet e shkatërruara nga tërmeti, ngrit vendbanime ushtarake të tipit castrum, prej të cilave njëri ka qenë edhe Beisana, emri i së cilës është ruajtur në emrin e fshatit të sotshëm Besia jo larg nga Prishtina në drejtim të Podujevës. E ka ripërtërirë edhe Ulpianën, e cila pas kësaj është quajtur Justiniana Secunda. Me gjithë këtë Justinianit nuk i shkoi për dore që ta ndalte depërtimin e barbarëve dhe të Sllavëve. Kjo ka ndikuar jo vetëm në dobësimin ekonomik por edhe në strukturën etnosociale të kësaj treve. Ndërsa ardhacakët zinin vendet në luginat e lumenjëve dhe rrafshina, popullata autoktone strehohej në kodra dhe male.

Për sa u përket proceseve shoqërore-ekonomike të territorit të sotshëm të Kosovës, në antikë e vonë ato kanë qenë identike me ato në pjesët e tjera të Ballkanit.

Mirëpo, popullata autoktone është e pranishme edhe më tutje në të gjitha format e jetës. Kjo qartë reflektohet në krishtërim dhe në jetën e organizuar kishtarë. Justiniana Secunda tani bëhet qendër e rëndësishme shpirtërore,

...deri në antikën e vonë

prof. dr. sc. Zef Mirdita

nga Universiteti i Zagrebit

kulturore dhe politike. Mund të thuhet se krishtërimi është këtu qysh nga fundi i shek. I-rë. Në kohën e perandorit Trajan kemi dy martir të krishterë në Ulpianë. Këta janë Lauri dhe Flori. Në shek. IV-të krishtërimi organizohet në hierarkinë e tij. Përkundrejt përndjekjeve dhe dhunës të perandorëve bizantin, hierarkia e saj gjithmonë ka mbetur në bashkim shpirtëror dhe kanonik me Kishën romake. Aktivitetin e tij të gjallë krishterim e ka shprehur në ngritjen e objekteve kishtarë dhe bazilikave (Ulpiana, Soçanica, Zaskoku te Ferizaji, Lipjani, Zhuri te Prizreni, Kosmaçi në Drenicë, kompleksi Galiqi te Mitrovica e Kosovës dhe vende të tjera).

(fund)

LITERATURA:

MÓCSY, András, Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior, Budapest 1970.
MÓCSY, András, A History of the Middle Danube Provinces of the Roman Empire. London and Boston – Routledge & Kegan 1974.
GARAŠANIN Draga, Iliri. Në: Iliri i Daçani – The Illyrians and Dacians. Narodni Muzej Beograd – Istorijski muzej Transilvanije – Kluj, Beograd 1971, 17-32.
SREJOVIĆ, Dragoslav, Karagač and the Problem of the Ethnogenesis of the Dardaniens. Në: Balcanica IV. Srpska Akademija nauka i umetnosti. Beograd 1973, fq. 39-82.
ČEŠKOV, Emil, Rimljani na Kosovu i Metohiji, Beograd 1969.
ČEŠKOV, Emil, Municipium DD kod Sočanice, Priština – Beograd 1970.
HAMP, Eric, Kukës and Prizren. Në: Recherches albanologiques. 2-1985. Institut Albanologique de Prishtina. Prishtina 1987, 57-58.
PAPAZOGLU, Fanula, Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba. Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine. Djela. Knj. XXX. Centar za balkanološka ispitivanja, knj. 1. Sarajevo 1969.
PAPAZOGLU, Fanula, The Central Balkan Tribes in Pre-Roman Times, Amsterdam 1978.
PAPAZOGLU, Fanula, Quelques aspects de l'histoire de la province de Macedoine. Në: Aufstieg und Niedergang der römischen Welt. II. Prinzipat 7, 1, Walter de Gruyter – Berlin – New York, 1979, fq. 302-369.
Iliri i Albanci. Srpska akademija nauka i umetnosti. Knj. XXXIX/10, Beograd 1988.
ŠAŠEL, Jaro, Dardania, Furi e Pontii. Në: Scritti sul mondo antico in memoria di Fulvio Grosso. A cura di Gasperini. Universita di Macerata. Pubblicazioni della Facolta di Lettere e Filosofia. 9. Giorgio Bretschneider editore – Roma, 1981, fq. 587-594.
GARAŠANIN, Milutin, Praistorija na tlu SR Srbije, I-II., „Srpska književna zadruga“, Beograd 1970.
MIRKOVIĆ, Miroslava, Einheimische Bevölkerung und römische Städte in der Provinz Obermösien. Në: Aufstieg und Niedergang der römischen Welt. II. Prinzipat 6, 1, 1977, fq. 828, 835-837, 840-843.
Praistorija na tlu jugoslovenskih zemalja, sv. II, III, IV, V, Sarajevo 1979, 1987.
DUŠANIĆ, Slobodan, Aspects of Roman Mining in Noricum, Pannonia, Dalmatia and Moesia Superior. Në: Aufstieg und Niedergang der römischen Welt. II. Prinzipat 6, 1, 1977, fq. 52-94.

DUŠANIĆ, Slobodan, Organizacija rimskog rudarstva u Noricu, Panoniji, Dalmaciji i Gornjoj Meziji 622(37). Në: Istorijski Glasnik. 1-2 (Beograd 1980), fq. 7-55.
MIRDITA, Zef, A propos de la romanisation des Dardaniens, në: Studia Albanica. Academie de sciences de la RP d'Albanie. Institut d'Histoire. Institut de Linguistique et Litterature. IX-2, Tirana 1972, fq. 287-298.
MIRDITA, Zef, Les origines des Dardaniens, në: Studia Albanica. X-2, Tirana 1973, fq. 117-149.
MIRDITA, Zef, Das Christentum und seine Verbreitung in Dardanien. Në: Balcanica IV. Srpska Akademija nauka i umetnosti. Beograd 1973, fq. 83-93.
MIRDITA, Zef, Zum Problem der Ethnogenese der Dardaner. Në: Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Zum Gedächtnis an Norbert Jokl. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Sonderheft 41. Hrg. Von Herman Oelberg, 1977, fq. 630-676.
MIRDITA, Zef, Problem rekonstrukcije pravca puta Vicianum-Gabuleum, në: Putevi i komunikacije u antici. Materiali XVII. Peć 1978, fq. 53-67.
MIRDITA, Zef, Studime Dardane (Dardanische Studien), „Rilindja“, Prishtinë 1979.
MIRDITA, Zef, Antroponimia e Dardanisë në kohën romake (Die Anthroponymie Dardaniens zur Römerzeit), „Rilindja“, Prishtinë 1981.
MIRDITA, Zef, Contribution à l'étude de la religion

et des cultes des Dardaniens à l'époque preromaine. Në: Recherches albanologiques 1-1984. Institut albanologique de Prishtina. Prishtina 1985, fq. 139-159.
MIRDITA, Zef, Die wirtschaftlichen und gesellschaftlichen Verhältnisse des Zentralgebietes Dardaniens in der Antike. Në: Balcanica XVIII-XIX. Srpska Akademija nauka i umetnosti Beograd 1987-1988, fq. 89-102 = Referati jugoslovenskih učesnika na V međunarodnom kongresu za proučavanje Jugoistočne Evrope održanom u Beogradu 1984, Beograd 1987 – 1988, fq. 89-102.
MIRDITA, Zef, Društveno-ekonomski odnosi na centralnom dardanskom području u željezno doba do njegovog uključivanja u rimsku upravu. Në: Histria Archaeologica, 20-21, 1989-1990, Pula 1995, fq. 79-89.
MIRDITA, Zef, Encore une fois sur le probleme d'ethnogenese des Dardaniens. Në: I. Iliri – Trački Simpozijum. Paleobalkanska plemena između Jadranskog i Crnog Mora od eneolita do helenističkog doba. Akademija nauka i umjetnosti Bosne i Hercegovine – Srpska akademija nauka i umetnosti. Sarajevo – Beograd 1991, fq. 101-110.
MIRDITA, Zef, O zapadnoj granici Dardanaca i Dardanije u antici. Në: Godišnjak. Knj. XXIX. Centar za balkanološka ispitivanja knj. 27. Akademija nauka i umetnosti Bosne i Hercegovine. Sarajevo 1991, fq. 163-184.

“Autobiografia e popullit në vargje”

(vjen ka faqja 13)

krijimtarinë popullore shqiptare nënvizohet fakti se eposi i kreshnikëve, pjesa kryesore e epikës heroiko-historike, shumica e rapsodive dhe baladave është një epikë malesh. Malet ishin të pranishme kudo, sidomos brenda njeriut shqiptar. Kjo provohet nga arbëreshët, të cilët “pas ikjes së tyre të pikëlluar në shekullin e pesëmbëdhjetë, atëherë kur humbën atdheun dhe sytë e tyre s'shihnin veç detin që i ndante nga Shqipëria, hijen e maleve e ruajtën, megjithatë, me vete edhe atje larg në fushëtitrat e mërgimit. E gjithë kjo vinte, sepse malet nuk ishin vetëm një faktor i rrokshëm: vend banimi, mbrojtje, kullotë. Ato ishin më tepër se kaq.

De Rada, lideri shpirtëror i arbëreshëve ka shkruar për to: ‘Malet janë një faktor që krijojnë drejtpeshimin, shmangin mendimet e parëndësishme, krijojnë një raport krahasimi midis individëve dhe vetë atyre’” (f. 93-94).

6. Në këtë libër të tij Ismail Kadare, edhe pse me një mënyrë shkrimi të shpejtë, edhe pse vetëm i prek shumë tema të rëndësishme, përpiket të japë një vlerësim të plotë për poezinë popullore shqiptare. Duke pasur si qëllim që të trajtojë që të gjitha problemet kryesore merret edhe me origjinën e eposit. Jep prova për lashtësinë e epikës shqiptare edhe në marrëdhëniet e saj me epikën sllave. Kundërshton studiuesit sllavë, sipas të cilëve edhe ngjarjet e kënduara në epikën kreshnike shqiptare i takojnë shekullit të XVII. Dhe mbështetet tek arbëreshët e Italisë: “Mirëpo këtu vjetërsia e ciklit shqiptar nga ai sllav ndahet përfundimisht, sepse cikli shqiptar zhytet papritur disa shekuj më thellë. Dhe kjo... vërtetohet edhe më thjesht me arbëreshët e Italisë. Të ikur në shekullin XV nga atdheu ata morën me vete një pjesë të epikës, që e ruajtën si në një urnë në mërgim. Një rapsodi e tillë si ‘Lule Frangu’ (Basti), e një gjinie me ciklin e kreshnikëve, tregon se ky cikël ishte ndërkaq i formuar në shekullin XV. Faktori arbëresh është i pakapërcyeshëm në diskutimin e vjetërsisë së dy cikleve. Ai vërteton pa diskutim ekzistencën e epikës shqiptare paraturke, pra, shumë përpara se të krijohet epika sllave” (f. 121).

Origjina lidhet ngushtë me kohën e formimit të Ciklit të kreshnikëve.

Koha e gjatë e procesit të krijimit të Ciklit fillon në mijëvjeçarin e parë, vazhdon në shekullin XII dhe deri në kohën turke.

Si përfundim për përcaktimin e kohës së formimit të Ciklit Kadare shkruan: “Por, duke pranuar tri kohë në formimin e ciklit, duhet të themi se formën e tij pak a shumë të tanishme, që, për fat të keq, nuk duhet të jetë më e mira, ai e mori në kohën e pushtimit osman. Prof. Çabej thotë se në këtë cikël shohim ‘tretjen e thërrmimin e kulturës së mesjetës së vonë, në kondita disi të egërsuara’. Ky mendim përkon me idenë e De Radës për poemën e vjetër shqiptare, nga mbeturinat e së cilës vazhduan të krijohen unitete të rinj poetikë, ashtu siç krijohen trupat qiellorë nga pluhuri kozmik” (f. 127).

Pra në librin e tij Ismail Kadare mbështetet tek poezia arbëreshe gjatë trajtimit pothuajse të çdo teme. Madje për disa tema elementi arbëresh është elementi kryesor. Kjo është një provë tjetër e lidhjeve midis botës arbëreshe, letërsisë arbëreshe dhe gjithë letërsisë shqiptare, si pjesë të të njëjtit sistem letrar.

Skanderbeg, tutore della Cristianità

Pierfranco Bruni

poet dhe shkrimtar, ka Sullarënxa (Cs)

Ci sono processi storici nel rapporto tra cultura Albanese e Italo – Albanese che non possono fare a meno di un personaggio che ha contraddistinto sia l’Albania, a cominciare dal XV secolo, sia i contesti territoriali dove la presenza Italo – Albanese ha avuto e ha una sua caratterizzazione. Mi riferisco a Scanderbeg.

Il dibattito non si è mai definito del tutto. Ritornano sulla scena della ricerca fatti e “resoconti” già sottolineati e la “storia che già si sa” non è completamente conosciuta se non soltanto dagli addetti ai lavori. Ma Scanderbeg, soprattutto nel nostro tempo, non può essere soltanto un riferimento per gli Albanesi o per i discendenti di questo popolo. Appartiene ormai a quella visione della cultura che va oltre ogni ideologizzazione e resta però dentro i connotati di una civiltà cristiana, Occidentale e Adrio – Mediterranea.

Scanderbeg, comunque, con le sue imprese ha riportato il Mediterraneo al centro dell’Occidente. “Skanderbeg, com’era stato soprannominato, tenne testa ai turchi per circa trent’anni e li sconfisse in venticinque battaglie. La sua eroica epopea commosse l’intera Europa che seguiva ammirata le imprese del condottiero albanese e Pio II definì l’Albania ‘antemurale Christianitatis Italiaeque’”. Così si legge nel recente saggio di **Arrigo Petacco** dal titolo: *L’ultima crociata. Quando gli Ottomani arrivarono alle porte dell’Europa* (Mondadori, 2007). Fatti già conosciuti, certamente, ma che assumono una valenza più universale all’interno di una realtà di storia più generale e non solo legata alla realtà Adrio – Balcanica.

Credo, pertanto, che sia una osservazione attenta che suggerisce una rilettura (e quindi una relativa contestualizzazione) della figura e della testimonianza di Giorgio Castriota Scanderbeg all’interno di un processo storico che pone all’attenzione due modelli culturali: quello Occidentale e quello Islamico – Orientale.

Si configura immediatamente un personaggio non più consegnato ad una trasfigurazione leggendaria (di leggendario non c’è nulla perché resta nella storia ed è storia) ma ricco di quei segni che sono vitali nella tradizione cristiana.

La lettura che si propone è quella di uno Scanderbeg come protagonista di un processo politico che spingeva l’Albania verso l’Occidente. Era questo l’obiettivo al quale puntava Scanderbeg.

L’Occidente costituiva un riferimento politico. Ciò lo portava a spostare l’asse storico – geografico verso un Mediterraneo occidentale (e quindi più Euro – internazionale) contrapponendosi all’avanzata dei Turchi che spingevano l’asse geografico verso Oriente o meglio cercavano l’attrazione di una parte di mondo verso un Mediterraneo Orientale.

Ma occidentalizzare l’Albania significava sostanzialmente blindare l’Albania, e parte dei Balcani, attraverso un consolidamento religioso e culturale rivolto ad una identità profondamente cristiana. Su questo non possono esserci più dubbi. La visione che aveva Scanderbeg era quella di porre la realtà di un Paese al servizio di tre capisaldi principali: il Papato, Venezia, il Regno di Napoli. Aspetti già definiti e storicizzati ma che vanno ricordati alla luce di una rilettura che rafforza le tesi di Scanderbeg come tutore della cristianità.

Un’altra testimonianza importante la si legge nel testo di **Fernando Gentilini**: *Infiniti Balcani. Viaggio sentimentale. Da Pristina a Bruxelles*, Pendagròn 2007, nel quale si legge: “Per tentare di salvare le proprie terre dall’Islam, Scanderbeg si era anche rivolto a Occidente, stringendo alleanze con il Papato, Venezia e i re di Napoli”. L’Occidentalizzazione che cercava Scanderbeg era, come già sottolineato, una precisa volontà di consolidare la cristianizzazione in Albania.

D’altronde dal punto di vista politico – ideologico combatteva una battaglia contro l’islamizzazione e questa battaglia significava avviare uno scontro ben definito con il popolo della mezza luna, ovvero con lo Stato Turco che, invece, tentava di islamizzare quell’Europa cristianizzata. Dal punto di vista religioso non poteva che rivolgersi, e non solo in termini di effetti economici, al Papato come esempio assoluto di una contrapposizione contro l’Islam.

Basilio Giordano kandidat Pdl për Senatën

(www.basiliojiordano.com)



Vasili Buzëdhelprit (Basilio Giordano) – ëmer e mëmë purçilote, mbiëmer e tatë frasnjot – është kandidat i partitit PDL (Populli i lirisë), për Senatën, në Çirkoskricjonën e Jashtme / Veri e Qendër Amerikë. Një nderë e madhe për të, për fëmilën dhe për Purçillin, katundi tij.

Mund e votarjen Talljant jashtë Talljes – çë ka Alaska njera te...Nikaragua – çë kanë Çitadinanxën (Qytetërimin) Talljane dhe janë shkruar tek llistat e Aire-s (Anagrafe Italiani Residenti all’Estero). Jo më se 359.852 vetë. E kanë zgjedhen, për Parlamentin e Rromës, dy Deputatë e një Senatër.

Vasili Buzëdhelprit u le ndë fjavar 1952, u diplomar ndë Horet (Castrovillari) e pra vate Rromë, ku u shkrua tek Universitata La Sapienza, Fakultatë e Gjuhëvet, dhe shurbej te Kollexhi Propaganda Fide, i Vatikanit. Po pra, gjatë udhëtimevet të tij, ndë Kanadhatë njohu një bilë siçilljanrash, Ninën, dhe ndër 1977 la Talljen e e martoi. E ç’ahirna rron te çitata e Montrealit. Ndërroi ndrishe ftiga po shurbej ngaherë vet. Bëri pakë politikë e shumë biznes. U Ilaurear, tek Universitata e Montrealit, mbi Arte e Scienze. Pra, ndër 1986, bjejt xhurnallin “Il Cittadino Canadese”, çë del një herë ndë javet: zu e shkruajt e u bë xhornallist. E me motin e zgjothtin si kryetar i Xhornallistravet Talljanë ndë Kanadhatë, kryetar i Shoqates s’Kosndinravet, kryetar i Federatës s’Shoqatavet Kalabreze, pjesëtar i drejtorisë s’Fusie-s (Federazione Stampa Italiana all’Estero). Ndër të tjerat, është edhe Kalor (Cavaliere) i Republikës Talljane.

Në Montreal, ku rron ka 31 vjet, është shumë i njohur, aq ka talljanët sa ka kanadhizët. Shumë Talljanë, të emigruar ndë Kanadhatë pa fargjë, xunë gjuhët, u vunë e shurbien e u bënë gjindë t’urtë, të bëgetë e të njohur. Mbi këta personaxhe Vasili shkruajt dy Libre, një lëtitsh e një franxhiz.

Tek sekulli i shkuar, mos një purçilot, në politikë, fjturoj kështu lart. Kem vemi dreq më prap për të gjëmi purçilotin **Muzio Basilio Pace** (1797-1865) dhe të birin **Giuseppe** (1826-1866), garibaldinra, të dy deputatë tek Parlamenti Talljan.

I uromi Vasilit, me gjithë zëmer, t’i gjasë këtime t’divë. E të jetë i zgjedhur Senatër ka shumë Talljanë të Kanadhaut e të Merkes ‘ bëgatë. Na e presmi Purçill t’i bëmi një festë të madhe. Po edhe ndëse s’kish t’vinxhonej, e falënderomi për nderën ç’i bëri fëmiles s’tij dhe katundit tij. Dhe Arbëreshvet.

Scanderbeg fu chiaramente un crociato che combatteva una guerra santa. Sempre nel testo di Petacco si legge che Pio II (ovvero Enea Silvio Piccolomini) cercò di convertire il sultano Mehmed II ma non ci riuscì e il Pontefice “dedicò da quel momento ogni suo pensiero all’organizzazione di una nuova crociata” tanto che nel 1463 “proclamò infatti la guerra santa”. Ma l’anno successivo Pio II morì ad Ancona e nel 1468 anche Scanderbeg, colpito da malattia, si arrese alla vita.

Qual è il punto di queste cesellature? Scanderbeg poneva l’Albania non all’interno di una cultura strettamente Balcanico – Orientale ma guardava con attenzione al Mediterraneo. Si poneva già la questione di assorbire l’Adriatico (in termini politici e storici e non solo geografici) dentro una questione prettamente Mediterranea.

Ciò lo spingerà sempre più verso un articolato processo culturale che vedeva insieme Occidente e Cristianità. Insomma fondeva l’essere cristiano con l’essere fedele all’Occidente. Una cosa non scontata e non facile in un tempo di grandi conflitti. Con la morte di Scanderbeg, infatti, gli Ottomani prendono il sopravvento. Il superamento dell’islamismo per Scanderbeg poteva avere una sua chiave di lettura nella capacità di uno Stato - Popolo di superare la cultura Adrio – Balcanica e nel riaffermare i valori di un Mediterraneo occidentale e cristiano.